



BPB

Banka e vendit tënd

2016 | RAPORTI
VJETOR






BPB

Banka e vendit tënd

2016

RAPORTI
VJETOR



Kur diçka është mjaft
e rëndësishme, atë duhet
bërë edhe nëse mundësitë
nuk janë në favorin tuaj.

Elon Musk

Mbreti Gent kishte
bërë shumë reforma ekonomike në Iliri,
e ndër to edhe prodhimin e monedhave,
para erës së re.

Sipas gojëdhënave, mbreti Gent ishte i
dhënë edhe pas luleve.

Gentiana luthea ishte lulja që ai rriti për
gruan e tij - Etutën ilire, dhe është pjesë
e identitetit të bankës së vendit tënd.



PËRMBAJTJA

8	Misioni & Vizioni	10	Struktura organizative
14	Letra e kryetarit të bordit	16	Letra e kryeshefit ekzekutiv
18	Rezultatet Financiare	22	Biznesi me klientë
26	Burimet njerëzore	28	Menaxhimi i riskut
30	Teknologjia informative	31	Pajtueshmëria
36	Përgjegjësia shoqërore	37	Organizimi dhe menaxhimi i proceseve
43-96	Raporti i audituesve të pavarur		


MISIONI


Të jemi partner i besueshëm i klientëve
në plotësimin e kërkesave financiare dhe
mbështetës i sigurt në zhvillimin e
gjithëmbarshëm të tyre.

VIZIONI


Vizioni i BPB-së është që të rritet në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim të mbështetjes së individëve dhe bizneseve në zhvillimin e tyre ekonomik.

STRUKTURA ORGANIZATIVE









Mos e quaj ëndërr,
quaje plan.

Autori i panjohur

LETRA E KRYETARIT TË BORDIT

Nëse viti 2015 ka qenë vit për ri-fokusim atëherë viti 2016 ka qenë dëshmitarë i rindërtimit të biznesit. Kjo ka kërkuar një qasje të re dhe në muajin maj, me skadimin e kontratës së Richard Beasley, Drejtor Ekzekutiv u emërua Arton Celina. Për t'i pasqyruar kërkuesat për ta çuar Bankën para dhe për ta mundësuar një ndarje të saktë të përgjegjësive, në muajin gusht si Zëvendës i dytë u emërua Artan Sadiku.

Gjatë këtij viti ka vazhduar ndryshimi i dukjes së degëve tona dhe disa degë i kemi zhvendosur në mënyrë që të mund t'i shërbejnë klientët tanë më mirë. Imazhi ynë i ri është plotësuar me ri-dizajnimin e brendshëm të degëve tona në mënyrë që t'i bëjmë ato më miqësore për klientët. Kjo është mirëpritur nga klientët tanë.

Rezultatet e vinit 2016 pasqyrojnë rezultatin e arritur nga ekipi i ri, përmes fokusit të tyre në klientë individë dhe biznese mikro dhe të vogla. Rritja e depozitave është arritur duke tërhequr një gamë të gjerë të klientëve të ri, ashtu që Banka të mos varet nga një numër i vogël i depozitorëve të mëdhenj. Një qasje e ngashme është përvetësuar edhe kur kemi të bëjmë me huadhënien.

Duke u fokusuar në klientë individë dhe biznese më të vogla ne kemi tërhequr shumë huamarrës të ri. Kjo ia ka mundësuar Bankës që ta bëjë shpërndarjen e rrezikut përgjatë një game të gjerë të huamarrësve.

Viti 2016 ka qenë një vit rekord për BPB-në, me rritje të profitit si dhe rritje në të dy anët e bilancit të gjendjes. Bordi ka besim në aftësinë e stafit për ta vazhduar rritjen e Bankës në mënyrë të kujdeshshme si dhe rritjen e fitimeve të mbajtura gjatë viteve të ardhshme.

Aksionarët tanë kanë qenë shumë të durueshëm dhe mbështetës dhe Bordi rekomandon pagesën e dividendës për herë të parë në historinë e Bankës. Ky është moment shumë i rëndësishëm në udhëtimin e Bankës.

Progresi i arritur nuk do të ishte i mundur pa energjinë dhe entuziazmin e menaxhmentit dhe të stafit, dhe Menaxhmenti e ka pasqyruar këtë përmes krijimit të sistemit të bonusit bazuar në performancë për të gjithë stafin.





Dëshiroj ta shfrytëzoj këtë rast që ta falën-derojë gjithë stafin e BPB-së që i kanë pranuar ndryshimet dhe pér përkushtimin e tyre që ta çojnë Bankën para. Unë kam besim se përmes tyre Banka do të vazhdojë të zhvillohet, të rritet dhe të gjenerojë kthim të mirë në kapitalin tonë aksionar.

Anëtarët e bordit kanë ofruar udhëzime dhe mbështetje pér Menaxhmentin e Bankës dhe dëshiroj ta përshëndesë kontributin e tyre pér suksesin e Bankës në vitin 2016.

Oliver Whittle
Kryetar i Bordit drejtues

A large, handwritten signature in gold ink, reading "Oliver Whittle". The signature is fluid and cursive, with a prominent initial 'O' and 'W'. It is positioned over a dark, textured background that appears to be a close-up of a person's face.

LETRA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Të nderuar lexues,

Viti 2016 për BPB-në ka qenë vit i ndryshimeve rrënjosore si në aspektin organizativ poashtu edhe në atë biznesor, e në të njëjtën kohë ka qenë vit jashtëzakonisht i suksesshëm që është vërtetuar edhe përmes indikatorëve financiar.

Ky vit ka qenë i suksesshëm për tërë sektorin financiar, sepse rritja e portfolios kreditore me mbi 10% paraqet një hap shumë të favorshëm për ekonominë në përgjithësi. Kjo rritje është dukshëm më e lartë se sa rritja ekonomike e vendit, gjë që ofron një bazë solide për zhvillim të mëtutjeshëm në vendin tonë. Në përcjellje të kësaj performance të sektorit financiar në vend, BPB-ja ka performuar mbi normat e rritjes së sektorit pothuajse në shumicën e indikatorëve financiar, gjë që na motivon dhe na bind se jemi në drejtim të duhur me angazhimet tona, pra në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe stabil institucional.

Ndryshimet kryesore gjatë vitit 2016, e që ende vazhdojnë, kanë të bëjnë me ri-pozicionimin e bankës në treg si një bankë e fokusuar drejt Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, sektor ky i cili përbën trungun e ekonomisë së vendit.

Duke i shërbyer këtij segmenti të biznesit, BPB-ja synon që t'i përbushë aspiratat e veta të shprehura në vizionin e saj, si bankë që investon dhe stimulon rritjen e NVM-ve përmes produkteve dhe shërbimit enkas të dizajnuar për këtë segment të klientëve.

Ky ri-pozicionim nënkupton edhe reformën e brendshme organizative, ku kërkesat e këtyre kategorive të klientëve do të reflektojnë edhe në funksionimin e brendshëm të operacioneve të bankës. Për këtë arsy, ne poashtu jemi mobilizuar që t'i bëjmë investimet e duhura në teknologjinë informative si dhe në kapitalin tonë të çmuar njerëzor. Trajnimë të mirëfillta dhe të disejnuara enkas për ngritje të kapaciteteve të personelit të bankës, kanë ndikuar në ofrimin e shërbimeve më të mira për klientë si dhe kanë përgatitur personelin të ballafaqohet me sfidat e modelit të ri të bërit biznes.



Pa dyshim, të gjitha rezultatet dhe ndryshimet e arritura janë materializuar përmes përkushtimit maksimal të stafit të BPB-së, të cilët me këtë rast i falenderoj pafundësisht për kontributin e tyre gjatë vitit 2016.

Bazuar në indikatorët makroekonomik, si dhe në bazë të informatave që vijnë nga mjedisi biznesor në vend dhe më gjerë, viti 2017 pritet të jetë vit i suksesshëm dhe ne jemi optimistë që brenda këtij viti përmes ri-pozicionimit BPB-ja do të jetë edhe më e pranishme në tregun finançiar, dhe do të jetë shtëpia e parë e shërbimeve financiare për NVM-të në Kosovë. Të gjitha investimet e bëra në vitin 2016 dhe vazhdimi i tyre në vitin 2017, janë gjithashtu një garanci e mirëfilltë për një performancë edhe më të mirë në vitin 2017!

Ju Faleminderit!
Arton Celina



Arton Celina



REZULTATET FINANCIARE

Banka për Biznes (këtu e tutje "BPB") gjatë vitit 2016 kishte të hyra neto nga interesi në shumën prej afër 8.2 milion euro. Kjo kategori e të hyrave përfaqëson rrith 67.2% të të hyrave të përgjithshme operative të bankës, dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej afër 0.6 milion euro ose 8.6%.

Shpenzimet e interesit për vitin 2016 ishin rrith 1.7 milion euro (2015: 1.7 milion euro). Norma mesatare e interesit në depozita kishte trend të rënies edhe gjatë vitit 2016, ndërsa depozitat e klientëve u rritën për 24.7 milion euro ose 21.4%.

Margjina neto e interesit ishte 8.1% në krahasim me 8.6% sa ishte vitin e kaluar.

Të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet në shumë prej 1.5 milion euro (2015: 1.4 milion euro) kishin kryesisht një nivel stabil gjatë vitit 2016, duke shënuar një rritje modeste prej 3.1% krahasuar me vitin paraprak. Edhe pse të hyrat bruto nga tarifat dhe komisionet janë rritur për 8.2%, ishin shpenzimet e tarifave dhe komisioneve që kishin një rritje më të lartë prej afër 26%, e të cilat shkaktuan zvogëlim në rritjen e të hyrave neto nga tarifat dhe komisionet.

Provizonet neto për kredi dhe mjete të tjera gjatë vitit 2016 u ulën për afër 0.5 milion euro duke shënuar nivelin neto prej 1.3 milion euro (2015: 1.9 milion euro). Nga kjo ulje, shumica (0.7 milion euro) është nga provizonet e ndara për kredi, përderisa provizonet për mjete të tjera shënuan një rritje prej 0.2 milion euro si rezultat i rritjes së pasurive të ri-poseduara të Bankës.

Shpenzimet operative të Bankës gjatë vitit 2016 u karakterizuan me një rritje prej 5.9%. Raporti i kostove operative mbi të hyrat operative shënoi përmirësim nga 56.4% sa ishte në vitin 2015 në 53.3%.

BPB-ja gjatë vitit 2016 arrii një profit neto prej 4.1 milion euro duke rritur kështu ekuitetin e aksionarëve nga 11.7 milion euro sa ishte në vitin 2015 në 15.9 milion euro në vitin 2016. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar arrii nivelin prej 30.0% në krahasim me 18.6% sa ishte në vitin 2015.


Gjatë vitit 2016, BPB-ja shënoi përmirësim të dukshëm edhe sa i përket treguesve të adekuatshmërisë së kapitalit, ku gjithsej kapitali mbi mjetet e peshuara me rrezik ishte 14.8% në krahasim me 13.6% sa ishte në vitin 2015.

Treguesi i Levës afariste mbërriti nivelin prej 9.6% në krahasim me 8.8% sa ishte në fund të vitit 2015.

Investimi në letra me vlerë të emetuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë vitit 2016, ka shënuar një trend të rritjes nga 10.3 milion euro sa ishte në vitin 2015, në 18.3 milion euro në fund të vitit 2016.


Edhe gjatë vitit 2016, BPB vazhdoi ta rrisë stabilitetin e fondevë duke u fokusuar në depozita më stabile dhe më afatgjata, si dhe në diversifikimin e strukturës së tyre duke kaluar prej depozitave me vlera më të mëdha nga institucionë të ndryshme, në depozita me vlera më të vogla nga persona fizikë dhe biznese SME, të cilat konsiderohen më të qëndrueshme dhe më stabile.

Banka vazhdoi bashkëpunimin me institucionet financiare ndërkontinentale siç janë Fondi Evropian për Evropë Juglindore (FEEJ) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ku u arkëtuan afér 2 milion euro nga marrëveshja paraprakisht e lidhur me FEEJ-in gjatë vitit 2015, si edhe 1 milion Euro kredi e re nga BERZH-i që do të përdorët për mbështetjen e kredive që kanë për qëllim ngritjen e eficiencës së energjisë.




Depozitat

2015 ■ 2016 □




Ekspozimet mbi 10% të kapitalit




Portfolio kreditore

2015 ■ 2016 ■



Kreditë jo-performuese



MARRËDHËNIA ME Klientë: BIZNESET DHE Klientët individual

Gjatë vitit 2016, BPB ka qenë e fokusuar në aktivitete të ndryshme dhe ka qenë aktive në përmirësimin e kualitetit të shërbimeve bankare të ofruara bizneseve Mikro, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) si dhe personave individë (PI). Në sektorin e korporative qëllimi ka qenë ruajtja e klientëve ekzistues, ku fokus ka qenë shfrytëzimi i shërbimeve elektronike dhe rritja e qarkullimit bankar të këtyre kompanive përmes BPB-së.

Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 portfollio kreditore neto ka shënuar rritje prej 18.7%, ndërsa depozitat e klientëve janë rritur për 21.8%. Gjatë vitit 2016, 49% e portfolios ishin ishin ekspozime të reja kreditore. Krahas rritjes së portfolios në secilin sektor ka pasur edhe përmirësim të konsiderueshëm të kualitetit të portfolios kreditore.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të klientëve gjatë vitit 2016, kemi dizajnuar oferta specifike për sektorë specifik me qëllim të ngritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të punës së bizneseve dhe klientëve individë.

Kjo strategji e të bërit biznes me dizajnimin e ofertave specifike do të vazhdojë edhe më tej, sepse bizneset dhe klientët individë kanë kërksa të ndryshme për sa i përket shërbimeve bankare dhe nevojave financiare.

Ofrimi i shërbimeve elektronike dhe ngritja e cilësisë së tyre ka qenë njëri nga priorititet kryesore të Bankës gjatë vitit 2016, pasi që këto shërbime ndikojnë drejtpërdrejt në kursimin e kohës dhe të shpenzimeve të klientëve. Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 numri i E-banking ka shënuar rritje prej 18%, Mobile-banking ka shënuar rritje prej 110% gjersa SMS banking ka shënuar rritje prej 131%. Përveç financimit me ekspozime kreditore, një nga qëllimet kryesore të bankës do të jetë ofrimi i shërbimeve elektronike dhe shërbimeve të tjera bankare për bizneset dhe klientët individë, si dhe rritja e qarkullimit bankar të bizneseve.

Në vazhdën e përkrahjes për financime në drejtim të eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtërishme, banka ka ndërmarrë projekte të reja për ta avancuar nivelin e investimeve në këtë drejtim.

18.7%

Portfolio neto kreditor
ka shënuar rritje prej

21.8%

Depozitat e klientëve

Andaj, duke marrë parasysh se NVM-të vazhdonë të luajnë rolin kryesor në zhvillimin ekonomik, përkrahja e këtyre projekteve ka qenë objektivë parësore e stafit tonë të specializuar për financime të projekteve të tilla. Si rezultat, ne si bankë e përkushtuar në zhvillimin e bizneseve Mikro dhe NVM, kemi nënshkruar marrëveshjen përfundim e Efiçencës së Energjisë me EBRD-në që është e ndërlidhur me programin e KOSEP-it, si dhe kemi pranuar fonde nga IFC-ja të cilat kanë qenë të ndërlidhra dhe kanë sjellë përfitime të drejtpërdrejta duke siguruar asistencën teknike për stafin i cili është në shërbim të drejtpërdrejtë të klientëve biznese.

Përveç tjerash, ne si bankë gjatë vitit 2016 kemi qenë shumë të fokusuar edhe në rritjen e mundësive të bizneseve të vogla dhe të mesme përfundim. Në ketë drejtim kemi nënshkruar marrëveshje me Fondin Kosovar përfundim, me që t'i u mundëson kreditore, në mënyrë që t'iu mundësojmë klientëve tanë, të cilët kanë plane përfundim por nuk kanë mbulueshmëri të kënaqshme të kolateralit. Andaj, kemi punuar shumë në identifikimin e klientëve të cilët i plotësojnë kushtet përfundime dhe kemi kredituar projekte të konsiderueshme të cilat kanë rezultuar të suksesshme në pikëpamje të FKGF-së si dhe bankës si kreditues.

Ky Fond do të na shërbejë në vazhdimesi si një storie e suksesit, me të cilën mendojmë dhe kemi planifikuar që ta zgjerojmë mundësinë përfundim qasje në financim edhe me linja të tjera të ngjashme.

Si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm përfundit, kemi gjatë vitit 2016 ka iniciuar projektin e ri-profilizimit të pozitës së arkëtarëve në pozitën e Zyrtarit përfundim Shërbime Bankare që nënkuption ofrimin e të gjitha shërbimeve bankare përfundim operimit me para të gatshme. Efekti i këtij ri-profilizimi ka rezultuar të jetë shumë i suksesshëm dhe i dobishëm në përfundit profesionale të stafit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve si përfundim kreditore ashtu edhe përfundim bankës.

BPB-ja ka një rrjet të gjerë të degëve dhe staf profesional që u mundëson klientëve të saj të kenë qasje të shpejtë dhe të lehtë në produktionet dhe shërbimet bankare. Edhe gjatë vitit 2016 është bërë përditësimi i pamjes së njësive të BPB-së përfundim ta reflektuar pamjen e re të bankës.





Një qëllim pa planifikim,
mbetet vetëm një ëndërr.

Robert Herjavec

BURIMET NJERËZORE

Burimet Njerëzore përmes ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore gjatë vitit 2016, kanë përkrahur strategjinë e bankës për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore ndaj klientëve.

BPB-ja konsideron se punonjësit janë faktori më i rëndësishëm për ngritjen e performancës së përgjithshme dhe realizimin e vizionit dhe misionit të Bankës. Prandaj, fokusi kryesor i Burimeve Njerëzore në vitin 2016 ka qenë rekrutimi i kandidatëve adekuat me kualifikim dhe kompetenca të larta, integrimi, trajnimi si dhe zhvillimi i tyre i mëtutjeshëm.

Sfidat aktuale të tregut bankar drejt digjitalizimit të shërbimeve janë parashikuar me ndryshimin e strukturës organizative, deregionalizimin e degëve, transformimin e pozitës Arkëtar në Zyrtar për shërbime bankare, organizimin e trajnimeve të brendshme, zhvillimin e kapaciteteve të stafit si dhe riorganizimin e proceseve operuese të Bankës, për të qenë sa më efikas në ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe sa më cilësore për klientët.

Fokus i veçantë i është kushtuar menaxhimit të performancës në nivel të bankës, që nga përcaktimi dhe komunikimi i qartë i objektivave tek punonjësit, e deri tek dhënia e vlerësimit objektiv dhe përcaktimit të hapave konkrete përmirësim të performancës aktuale.

Në mënyrë që ta motivojmë dhe ta mbajmë stafin me performancë të shkëlqyer në punë, kemi aplikuar faktorë të ndryshëm motivues si dhe kemi vlerësuar dhe shpërblyer punonjës për performancën dhe arritjet e tyre.

Burimet Njerëzore, gjatë vitit 2016 kanë mbështetur realizimin e planit strategjik të Bankës përmes proceseve si:



MENAXHIMI I RISKUT

Gjatë vitit 2016 departamenti i riskut është angazhuar në menaxhimin dhe avancimin e proceseve të bankës, për të siguruar pajtueshmëri të plotë me kërkesat rregullative të BQK-së.

Lidhur me këtë, është bërë rishikimi i dokumenteve ekzistuese, si dhe janë krijuar dokumente shtesë sipas kërkesave të reja rregullative. Ndërsa, për rishikimin dhe avancimin e mëtejmë të proceseve në departamentin e riskut banka ka shfrytëzuar mbështetjen nga EFSE-ja përmes Asistencës Teknike që iu është miratuar bankës, e për realizmin e së cilës është angazhuar një kompani profesionale lokale.

Gjatë këtij viti është bërë ndryshimi i strukturës organizative të bankës, ku njësitë e kontrolleve të brendshme janë larguar nga departamenti i riskut dhe kanë kaluar nën menaxhimin e departamentit të kontrolleve të brendshme. Përmes këtij ristrukturimi është rritur edhe më shumë fokusi dhe angazhimi për menaxhimin e fushave të riskut. Lidhur me këtë, banka ka angazhuar edhe staf shtesë të specializuar në menaxhimin e fushave specifike në departamentin e riskut, më saktësisht një specialist për menaxhimin dhe miratimin e kredive AGRO, si dhe një specialist për menaxhimin e portfolios kreditore.

Gjatë kësaj periudhe, banka ka bërë investime edhe në aplikacione të reja që ndihmojnë në automatizimin dhe menaxhimin më efikas të proceseve.


Në këtë drejtim, krahas aplikacionit ekzistues të riskut kreditor, banka ka zhvilluar edhe një aplikacion shtesë për menaxhimin e riskut kreditor, respektivisht për miratimin e kredive në mënyrë elektronike. Krahas kësaj, banka ka filluar edhe me zhvillimin e aplikacioneve të reja shtesë për menaxhimin e procesit të monitorimit të kredive, si dhe aplikacionin për menaxhimin e kredive në vonesë.

Krahas përmirësimit dhe avancimit të menaxhimit të proceseve, gjatë vitit 2016 banka ka përmirësuar edhe me tej cilësinë e kredive, respektivisht kredive jo performuese, ku niveli i këtyre kredive në BPB ka arritur në nivelin e njëjtë me mesataren e kredive jo performuese në nivel të industrisë bankare. Në këtë drejtim, banka ka ndërtuar dhe avancuar edhe me tej kapacitetet njerëzore brenda bankës për menaxhimin e kredive në vonesë, si dhe ka vazhduar bashkëpunimin me kompanitë e jashtme për menaxhimin e kredive jo performuese dhe të shlyera (write-off).

Gjatë kësaj periudhe kohore banka gjithashtu ka vazhduar me diversifikimin e ekspozimeve kreditore, përkatësisht ka zvogëluar ekspozimet e mëdha kreditore nën nivelin prej 10 % të kapitalit të klasit të parë.

Krahas menaxhimit të riskut kreditor, banka ka avancuar menaxhimin e proceseve edhe përfushat e tjera, siç janë: menaxhimi i riskut operacionali, riskut të likuiditetit, riskut të normës së interesit, riskut valutor, si dhe risqeve të tjera. Vlen të përmendet se është krijuar udhëzuesi dhe matrica për provizionimin e kontesteve gjyqësore, dhe është krijuar seti i ri i dokumenteve për menaxhimin e riskut të normës se interesit sipas kërkesave të reja rregullative të BQK-së.

Provizonet në raport me NPL



Departamenti i riskut do të merret edhe me zbatimin e kërkesave të reja ligjore që do të vijnë së shpejti si rrjedhojë e zbatimit të Basel Pilar II që është duke u zbatuar nga BQK-ja, ku ndër projektet më të rëndësishme që do të zbatohen janë: ICAAP (Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjafthueshmërisë së kapitalit), si dhe IFRS.



ZVOGËLIMI I EKZPOZIMEVE TË MËDHA KREDITORE NËN NIVELIN

10%

Three red downward-pointing arrows originate from the top right and point towards the "10%" value, emphasizing the reduction in exposure risk.

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Teknologjia informative është e orientuar në ofrimin mbështetjes për bankën dhe klientët e saj duke zbatuar pajisje dhe procese bashkëkohore të cilat lehtësojnë operacionet ditore dhe përdorimin produkteve të bankës.

Departamenti i Teknologjisë Informatice ofron menaxhim të sigurtë të bazave të dhënave, sistemeve kompjuterike dhe aplikacioneve tjera për të avancuar edhe më tutje shërbimet bankare për klientë.

Misioni i Departamentit të Teknologjisë Informatice është që të nxitë sa më shumë përdorimin kreativ dhe inovativ të teknologjisë për të arritur objektivat e bankës.

Duke promovuar administrim efektiv të pajisjeve dhe teknologjisë moderne, Banka ka në fokus investimet në infrastrukturë dhe në avancim të vazhdueshëm të shërbimeve ndaj klientëve. Jemi të përkushtuar në platformat e bankimit elektronik, e-Banking dhe m-Banking, si dhe rrjeti i bankomatëve me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më kualitative dhe në mënyrë sa më efikase, të sigurtë dhe të qëndrueshme.



PAJTUESHMËRIA

Pajtueshmëria me rregullatorin – Trendi i vazhdueshëm i rritjes së kërkesave rregullative në Kosovë ka bërë që menaxhimi i pajtueshmërisë të kthehet në prioritet kryesor të sektorit bankar. BPB sigurohet që krahas kërkesave rregullative, si ato vendore dhe ato ndërkombëtare, të cilat çdoherë e më shumë po rriten, të krijojë një infrastrukturë ligjore rregullative të brendshme në përputhje me këto zhvillime, që Bankën e bënë një vend më të sigurt për klientin.

Parandalimi i pastrimit të parave/ft – Kemi krijuar standarde të larta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe kërkojmë nga menaxhmenti dhe punonjësit respektimin e këtyre standardeve. Për zbatimin e këtyre standardeve janë krijuar politika dhe procedura sipas dispozitave të përcaktuara në përputhje me Ligjin nr. 05/L -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, ligjin aktual për banka, rregullën/rregulloren aktuale të BQK-së për parandalimin e PP/FT, dhe me standaret aktuale ndërkombëtare të cilat kërkojnë nga bankat ngritjen e sistemeve adekuate për ta luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Njih Klientin Tuaj – (NjKT -“KYC”) - Me qëllim të verifikimit të identitetit të klientëve të saj dhe përmirësimit të kualitetit të të dhënavë, Banka e ka implementuar procesin njih klientin tuaj. Përmes këtij procesi synohet ruajtja e një klientele sa më të identifikuar dhe në pëputhje të plotë me parimin e Bankës “Ne rritemi përgjegjshëm” dhe gjithashtu sipas kërkesave ligjore dhe rregullative.

Mbrojtja e të dhënavë personale – ne sigurohemi që të dhënat e klientëve të janë të mbrojtura dhe të sigurta siç edhe kërkohen me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale.

Trajnimet - Për këtë BPB ka krijuar program me gamë të gjerë të trajnimeve me temat e pajtueshmërisë që të ngris vetëdijen dhe të sigurohet se zbatohet rregullativa dhe që produktet dhe shërbimet e Bankës nuk përdoren për t'i pastruar paratë e fituara nga aktivitete kriminale dhe se të gjithë punonjësit e Bankës, pavarësisht nga pozita, janë të vetëdijishëm për obligimet e tyre ligjore dhe nevojën për të qenë vigjilentë në luftën kundër pastrimit të parave/financimit të terrorizmit.



Mundohu të
arrishë yjet, ndoshta
thjeshtë mund t'a
kapësh një.

Lori Greiner



Banka me Përgjegjësinë
Sociale më të mirë në
Kosovë në vitin 2016



Banka Komerciale me
rritjen më të shpejtë në
Kosovë në vitin 2016

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE

Që nga themelimi i bankës, BPB krahas aktiviteteve biznesore banka ka pasur për qëllim edhe të jetë pjesë e komunitetit, duke operuar në mënyrë të përgjegjshme.

Qëllimi ynë është i përqendruar në mbështetjen e komunitetit dhe në ndërtimin e platformave drejt rezultateve pozitive, duke vepruar jo vetëm si entitet biznesi, por edhe si pjesë e komunitetit në të cilin veprojmë. Jo vetëm që jemi të përgjegjshëm në aktivitetet tona, por edhe ndajmë përgjegjësinë me aksionarët në lidhje me promovimin e vlerave të shoqërisë, si brenda kompanisë ashtu edhe në komunitet.

Programi i përgjegjësisë shoqërore i bankës BPB zhvillon praktikat më të mira shoqërore, mjedisore dhe komerciale dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik të vendit.

Përveç tjerash, programi mbështetë grupe të ndryshme të komunitetit, me qëllim të promovimit të të drejtave të barabarta dhe të diversitetit.

Aktivitetet e përgjegjësisë shoqërore të BPB-së vënë në fokus bizneset e vendit dhe produktet vendore. Si ndër bankat më dinamike të vendit, banka përmes aktiviteteve të përgjegjësisë shoqërore ka mundësuar punësimin e dhjetëra Kosovarëve, pjesë e ndërmarrjeve dhe iniciativave të prod-huesëve vendor. Për të zhvilluar aktivitetet e përgjegjësisë shoqërore, banka bashkëpunon me një numër organizatash duke përfshirë edhe Shoqatën e Down Syndrome Kosova dhe shoqatat e grave në Krushë dhe Janjevë.



ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I PROCESEVE

Në ritmin e ndryshimit dhe rimodelimit të strukturës së bankës të bërë në mesin e vitit 2016, u krijuau edhe departamenti i ri për Organizim dhe Menaxhim të Proceseve (OPMD).

Menaxhimi i proceseve si disiplinë në vete ka për qëllim përmirësimin e performancës së institucionit dhe në këtë drejtim roli i OPMD-së është një shtytje drejt përsosmërisë operacionale dhe lirimtë të kohës për të bërë më shumë në aspektin e avancimit të biznesit.

Është arritur pavarësisht sfidave që sjellë kjo përgjegjësi, pasi u ri-dizajnuan dhe u ri-modeluan proceset kryesore në procese më efikase dhe më efektive. Kjo u bë përmes rivendosjes së proceseve që përbajnjë në vete shumë hapa dhe aktivitete të panevojshme, si dhe përmes ndryshimit të bashkëpunimit në mes departamenteve nga të vepruarit në mënyrë individuale në një bashkëpunicim të mirëfilltë dhe të organizuar mirë.

Stabilizimi i proceseve në mënyrë graduale siguron shpejtësi dhe fleksibilitet, të cilat janë pika kyqe për të ndihmuar bankën që të jetë sa më konkurrente në tregun e sotëm. Fleksibiliteti ndaj ndryshimeve ndriçon rrugën e suksesit që ka në fokus linjën frontale, e gjithashtu përmbush nevojën për ndryshime që mund të vijnë si rezultat i faktorëve të brendshëm ose të jashtëm.

Në këtë rast ndryshimet mund të vijnë si kërkesë e vetë bankës ose kërkesave rregullative, ose edhe si pasojë e ndryshimeve makroekonomike, e që të gjitha këto kërkojnë transformim rrënjosor.

Riorganizimi dhe rivendosja më e përshtatshme e proceseve, e ndihmojnë bankën që të arrijë objektivat strategjike dhe e bën atë të jetë më fitimprurëse dhe më konkurrente në tregun në të cilin vepron.





Disa ändärrojnë suksesin,
pérderisa tjerët zgjohen
çdo mëngjes pér të realizuar
atë.

Wayne Huizenga



Përmbytja

Raporti i Auditorit të Pavarur

Pasqyrat Financiare

Faqe

Pasqyra të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	3
Pasqyra e Rrjetës së Parasë	4
Shënimë për Pasqyrat Financiare	5-50



EY
Building a better
working world

Ernst & Young Certified Auditors Ltd -
Kosovo
Rr Pashko Vasa 16/7
Prishtine, Kosova

Tel +381 38 220 155
Fax +381 38 220 155
ey.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Banka për Biznes sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka për Biznes sh.a. (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më datë 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës se parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera svaruese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare jepin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financier të Bankës më 31 dhjetor 2016, dhe të rezultatit të saj financier dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Çështjet tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015 janë audituar nga auditor tjetër që lëshoi opinion të pakualifikuar më datë 31 mars 2016.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrapin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës të Kontabilitetës të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodit IESBA) së bashku me kërkuesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhimenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontolle të brendshme, që menaxhimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhimenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvèç se në rastin kur menaxhimenti synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvèç si më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqueve, dhe marrim evidencia auditimi që janë të mjafqueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrëthanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmérinë e e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Banka për Biznes sh.a., përvèç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të kemi identifikuar gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k.
Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k

Prishtinë, Kosovë

7 prill 2017

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016


<i>Në mijë Euro</i>	Shënimë	2016	2015
Të ardhurat nga interesi	6	9,821	9,173
Shpenzimet e interesit	6	(1,670)	(1,669)
Të ardhurat neto nga interesi		8,151	7,504
Të ardhurat nga tarifa dhe komisionet	7	2,000	1,848
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet	7	(522)	(414)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet		1,478	1,434
Kthimi nga kreditë e shlyera		583	534
Fitimi neto nga këmbimi valutor		(2)	70
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		1,878	120
Të ardhurat tjera operative		35	100
Gjithsej të ardhurat operative		12,123	9,762
Humbjet nga kreditë të rëna në vlerë	15	(830)	(1,584)
Kthimi i provizionit për kërkesat ndaj garancioneve		10	19
Ulja e vlerës së pasurive të riposeduara	16	(529)	(305)
Provizione tjera	23	(622)	(642)
Shpenzime tjera operative	8	(5,622)	(5,249)
Gjithsej shpenzimet operative		(7,593)	(7,761)
Fitimi para tatimit		4,530	2,001
Shpenzimet e tatimit në fitim	9	(387)	-
Fitimi neto për vitin		4,143	2,001
Të ardhurat gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që janë ose mund të ri-klasifikohen në fitim apo humbje</i>			
Rezerva për vlerën e drejtë (pasuritë financiare për shitje)		(14)	(18)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		4,129	1,983

Pasqyra e të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2016

Në mijë Euro	Shënimë	2016	2015
Pasuritë Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	10	12,691	10,623
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	11	27,248	22,576
Kreditë dhe paradhënet për bankat	12	600	960
Pasuritë financiare të vlefshme për shitje	13	18,267	10,372
Kreditë dhe paradhënet për klientët	14	103,149	87,025
Pasuritë tjera financiare	15	237	291
Pasurië tjera	16	141	122
Pasuritë e riposeduara	17	898	747
Pasuritë e paprekshme	18	226	147
Prona dhe pajisjet	19	980	1,041
Gjithsej pasuritë		164,437	133,904
 Detyrimet			
Depozitat nga klientët	20	140,598	115,848
Kreditë e varura	21	1,845	1,848
Huamarrjet	21	4,248	3,017
Detyrim për tatimin e shtyrë	9	126	105
Detyrime tjera	22	1,346	703
Provizione tjera	22	404	642
Gjithsej detyrimet		148,567	122,163
 Ekuiteti			
Kapitali aksionar	23	11,247	11,247
Rezerva tjera	23	857	857
Rezerva për rivlerësim	23	96	96
Rezerva për vlerën e drejtë		(32)	(18)
Fitimi/(humbja) e akumuluar		3,702	(441)
Gjithsej ekuiteti		15,870	11,741
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		164,437	133,904

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga menaxhmenti i Bankës më 1 mars 2017 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:


Arton Celina
Kryeshef Ekzekutiv


Avni Berisha
Udhëheqës i Departamentit të Financave

Pasqyra e pozicionit finanziar lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
 Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

	Kapitali aksionar	Rezerva tjera	Rezerva për rivlerësim	Fitimi / (humbja) e akumuluar	Rezerva për vlerën e drejtë	Gjithsej
<i>Në mijë Euro</i>						
Gjendja me 1 janar 2015	11,247	857	96	(2,442)	-	9,758
Transaksionet me aksionarët e Bankës	-	-	-	-	-	-
<i>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</i>						
Fitimi i vittit	-	-	-	2,001	-	2,001
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse (rezerva e vlerës së drejtës)	-	-	-	-	(18)	(18)
<i>Gjithsej të ardhurat/(humbja) gjithëpërfshirëse</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	11,247	857	96	(441)	(18)	11,741
Gjendja më 1 janar 2016	11,247	857	96	(441)	(18)	11,741
Transaksionet me aksionarët e Bankës	-	-	-	-	-	-
<i>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</i>						
Rezerva e rivlerësimit	-	-	-	-	-	-
Fitimi i vittit	-	-	-	4,143	-	4,143
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	(14)	(14)
<i>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	11,247	857	96	3,702	(32)	15,870

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri ne faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimë	2016	2015
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit para tatimit		4,530	2,001
<i>Zërat jo-monetary në pasqyra financiare:</i>			
Zhvlerësimi	19	321	281
Amortizimi	18	77	87
Fitimi nga shitja e pronave dhe pajisjeve		(21)	(30)
Humbjet nga kreditë të rëna në vlerë	14	830	1,584
Rënia në vlerë për pasuritë e riposeduara	17	529	305
Provizione tjera		395	-
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		(1,878)	-
Shpenzimet e interesit	6	1,670	1,669
Të ardhurat nga interesi	6	(9,821)	(9,173)
		(3,368)	(3,276)
Ndryshimet në:			
Kredi dhe paradhënie për bankat	12	360	251
Kredi dhe paradhënie për klientet	14	(16,524)	(13,599)
Rezerva e detyrueshme në BQK	11	(3,248)	(1,066)
Pasuri tjera	16	(19)	127
Pasuri tjera financiare	15	54	168
Pasuritë e riposeduara	17	-	(209)
Depozitat nga klientët	20	24,723	13,049
Detyrime tjera dhe provizione		643	858
Interesi i arkëtuar		9,967	9,142
Interesi i paguar		(1,684)	(1,873)
Tatimi në fitim i paguar		(290)	-
		10,614	3,572
Neto paraja e gjeneruar në aktivitetet operative			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Investimet në pasuritë financiare të vlefshme për shitje	13	(7,927)	(10,390)
Të hyrat nga shitjet e investimeve të mbajtura deri në maturitet		-	7,242
Blerja e pronave dhe pajisjeve	19	(276)	(711)
Blerja e pasurive të paprekshme	18	(156)	(89)
Të hyrat nga shitja e pronave dhe pajisjeve		37	61
		(8,322)	(3,887)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet investuese			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesa e huamarrjeve	21	(800)	-
Inkasimet nga huamarrjet	21	2,000	3,017
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		1,200	3,017
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		3,492	2,702
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	10	24,154	21,452
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	10	27,646	24,154

Pasqyra e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe)

1. HYRJE

Banka Private e Biznesit Sh.a ka marrë licencën për aktivitete bankare me 29 mars 2001 dhe ka filluar operimin me 24 prill 2001.

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtoreve më 28 shkurt 2005 dhe pas miratimit final nga Banka Qëndrore e Kosovës ("BQK") më datë 22 mars 2005, Banka ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit në Banka për Biznes ("Banka"). Në vitin 2006, Banka është regjistruar si shoqëri aksionare ("Sh.a"). Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve dhe 19 nën degëve të saj të vendosura në Kosovë (2015: 7 degëve dhe 19 nën degë).

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Pasqyra e pajtueshmerisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përvèç pasurive financiare të vlefshme për shitje të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

c) Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro e cila është valuta funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullaksuar në mijëshen më të afërt, përvèç nëse është cekur ndryshe.

d) Përdorimi i gjykimeve dhe i vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, manaxhmenti ka bërë gjyke, vlerësimë dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe mbi shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të kenë ndryshim nga këto vlerësimë.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi elementet e rëndësishme me pasiguri në vlerësimë dhe mbi gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël me efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 25.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(Shumat në '000 Euro, përvëç nëse është cekur ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat e kontabilitetit të paraqitura me poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje me metodën efektive të interesit. Norma e interesit efektiv është norma që bënë aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të prishme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së prishme të pasurisë ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e bartur të pasurisë ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogarita e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuara, të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një pasurie apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

- Interesat nga pasuri ose detyrime financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv dhe;
- Interesat nga investime të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

b) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhurat e tjera nga tarifat dhe komisionet përfshirë edhe tarifat e shërbimeve të llogarive, tarifat e transferimit të fondevë, komisione shitjesh dhe tarifa pë vendosje me afat në banka njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një angazhim për kreditim nuk pritet të rezultojë në térheqjen të kredisë, komisionet e kredisë përkatëse njihen në bazë lineare përgjatë periudhes së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

c) Pagesat e qirasë

Pagesat për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimeve për qira, përgjatë afatit të qirasë.

d) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhes me përashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në ekuitet ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatushme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(Shumat në '000 Euro, përvëç nëse është cekur ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**d) Shpenzimet e tativit (vazhdim)***(ii) Tatimi i shtyre*

Tatimi i shtyre njihet mbi diferençat e përkohshme që dalin midis bazës tativore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyre nuk njihet për diferençat e përkohshme që lindin në momentin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjne një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në fitimin/humbjen kontabël dhe as në atë të tatushme.

Matja e tativit të shtyre reflekton pasojat tativore që do ta percjellin menyrën në të cilën banka pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendos vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyre matet sipas normave tativore që priten të aplikohen në diferençat e perkohshme kur ato kthehen, përmes normave tativore në fuqi në datën e raportimit.

Mjetet dhe detyrimet tativore të shtyera kompensohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta kompensuar me mjetin dhe detyrimin e tativit dhe kur ndërlidhen me tativit e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tativor. Tatimet shtesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendës nga ana e bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendën respektive.

Një pasuri tativore e shtyre njihet për humbjet sipas tativeve, kredive tativore dhe dallimet e përkohshme të zbritshme të pushfrytëzuar, vetëm në atë masë që është e mundur të shfrytëzohet për fitimet e ardhshme të tatushme, kundër të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Pasuritë e tativit të shtyre rishikohen në secilën datë të raportimit dhe reduktohen në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tativi të realizohen.

(iii) Ekspozimet tativore

Në percaktimin e shumës së tativit aktual dhe të shtyre, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tativore të pasigurta dhe nëse tativi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimë dhe supozime dhe mund të perfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tativore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tativore do të ndikojnë në shpenzimet tativore të periudhës në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

e) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj rivlerësohen në valutën funksionale përkatëse të Bankës në kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit të normës së këmbimit në po atë datë.

Fitimi ose humbja nga zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale me kursin e këmbimit në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në valutë të huaj me kursin e këmbimit në fundin e vitit.

Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në valutë të huaj që maten me vlerën e drejtë, janë konvertuar në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetar që matën në bazë të kostos historike në valutë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(*Shumat në '000 Euro, përvëç nëse është cekur ndryshe*)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(i) Njohja

Banka fillimi si njeh kreditë dhe parahëniet, investimet e mbajtura deri në maturitet dhe të vlefshme për shitje, depozitat, huamarrjet dhe borxhet e varura në datën që ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka angazhohet për të blerë ose shitur pasurinë. Të gjitha pasurite dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimi si në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një pasuri ose detyrim financiar fillimi si matet me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen apo lëshimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Banka klasifikon pasuritë e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme;
- Të mbajtura deri në maturitet;
- Mjete financiare të vlefshme për shitje
Shiko shënimet 3.(g), (h), (i) dhe (j).

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare si të matura me kosto të amortizuar. Shih shenimin 3.(k).

(iii) Çregjistrimi

Pasuritë financiare

Banka e çregjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuese mbi rrjedhat e parasë nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat përmarrë rrjedhat monetare kontraktuese në një transakcion në të cilin kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë të pasurisë financiare janë transferuar apo në të cilin Banka as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë dhe mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për çregjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Banka njihet si një pasuri ose detyrim më vete.

Me çregjistrimin e pasurisë financiare diferenca ndërmjet vlerës bartëse të pasurisë (ose vlera e bartur e ndarë për pjesën e pasurisë që po çregjistrohet) dhe shumës së konsideratës së pranuar (i) (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar minus çdo detyrimi të ri të marrë përsipër) dhe (ii) dhe çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale përfundojnë apo anulohen, apo u skadon afati.

(iv) Kompensimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare kompensohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore përmes kompensuar shumat dhe synon ose i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, apo përmes dështimit të humbjet që vijnë nga një grup i transaksioneve të ngjashme sikurse nga aktiviteti komercional i bankës.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe)**3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)****Detyrimet financiare (vazhdim)****(v) Matja e kostos së amortizuar**

“Kostoja e amortizuar” e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus shlyerjet e kryegjës, plus ose minus amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferençë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus zbritjet eventuale për shkak të rënies në vlerë.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

“Vlera e drejtë” është çmimi që do të merrej nëse shitet një pasuri ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transakcion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rezikun e mosekzutimit të tij. Kur ka mundësi, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet aktiv nëse transakcionet për pasurinë ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për ofruar informata për çmimet në bazë të vazhdueshme.

Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatës të vëzhgueshëm dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshëm. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshinë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh gjatë vendosjes së çmimit të një transaksiom.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transakcionit – d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transakcionit dhe vlera e drejtë nuk dëshmohet as me çmim të kuotuar në treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik dhe as në bazë të një teknike vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vëzhgueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, të korrigjuar për të shtyrë dallimin ndërmjet vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksiomit. Më pas, ky dallim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi përkrahet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transakzioni të mbyllt.

Në qoftë se një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkueshës, atëherë Banka mat pasuritë dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmimin e kërkueshës.

Vlera e drejtë e depozitës sipas kërkueshës nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkueshës, e skontuar nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t'u paguar. Banka njeh transferet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë**Kreditë e rëna në vlerë dhe paradhëni**

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që pasuritë financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë provizonuar. Një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare janë provizonuar kur evidencia objektive demonstron se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare të pasurisë ose grupeve të pasurive dhe që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

*(Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe)***3. POLITIKAT E RËNDESISHME KONTABËL (vazhdim)****f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)***(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)***Kreditë e rëna në vlerë dhe paradhëni (vazhdim)**

Evidenca objektive që pasuritë financiare janë provisionuar mund të përfshijë vështirësi financiare të konsiderueshme të huamarresit ose emetuesit, mospagesa nga huamarrësit, ristrukturimin e një kredie apo paradhënie nga Banka me kushte që Banka nuk do ti kishte konsideruar, indikacione që një huamarrës ose huadhenës po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup pasurish të tillë si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarresit ose emetuesit në grup apo kushtet ekonomike që lidhen me dëshmitin në bankë.

Banka konsideron dëshmitë për zhvlerësimin e kredive dhe paradhënieve si në nivel individual ashtu edhe në nivel grupei. Të gjitha kreditët dhe paradhëni individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Ato të cilat nuk janë të zhvlerësuara në mënyre specifike, vlerësohen në grup për çdo zhvlerësim të ndodhur, por për të cilin nuk janë identifikuar akoma.

Për qëllime të vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rezikut të kredisë (llojin dhe shumën e kredisë). Bazuar në të dhënat historike për secilin prej grupeve llogaritet një faktor i humbjes. Këta faktori të pritshëm të humbjes janë rregulluar me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredisë janë të tillë që humbjet aktuale të janë më të mëdha ose më të vogla se tendencat historike dhe më pas ato janë aplikuar për të vlerësuar humbje nga zhvlerësimi në secilin grup. Normat e dëshmitit në pagesë, normat e humbjes dhe koha e pritshme e rikuperimeve të ardhshme krasaohën rregullisht kundrejt rezultateve aktuale për tu siguruar që ato vazhdojnë të janë të përshtatshme.

Humbja nga pasuritë e rëna në vlerë sipas kostos së amortizuar llogaritet si diferenç mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë.

Nëse kushtet e një pasurie financiare janë rinegociuar ose modifikuar ose një pasuri financiare ekzistuese është zëvendësuar me një të re për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë bëhet një vlerësim për të përcaktuar nëse pasuria financiare duhet të çregjistrohet ose jo. Nëse flukset monetare të pasurisë të rinegociueshme ndryshojnë rrënjosht, atëherë të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare nga pasuria financiare filletar konsiderohen të skaduara. Në këtë rast pasuria financiare originale çregjistrohet dhe pasuria e re financiare njihet me vlerën e drejtë.

Humbja nga zhvlerësimi matet si me poshtë:

- Në qoftë se ristrukturimi i pritur nuk çon në çregjistrim të pasurisë ekzistuese, flukset e vlerësuarat të mjeteve monetare që rrjedhin nga pasuria financiare e modifikuar përfshihet në matjen e pasurisë ekzistuese bazuar në kohën e pritur të tyre dhe të shumave të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiar ekzistues.
- Në qoftë se ristrukturimi i pritur rezulton në çregjistrim të aktivitës ekzistuese, atëherë vlera e pritur e drejtë e aktivitës të ri trajtohet si fluksi monetar i fundit nga aktivitë financiare ekzistuese në kohën e çregjistrimit të tij. Kjo shumë është e skontuar nga data e pritshme e çregjistrimit në datën e raportimit, duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritje përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesi mbi pasuritë e zhvlerësuara vazhdon të njihet nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit, shkakton ulje në humbjen nga zhvlerësimi, atëherë ulja e humbjes nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
 Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(Shumat në '000 Euro, përvëç nëse është cekur ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Kreditë e rëna në vlerë dhe paradhëniet (vazhdim)

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritje kundrejt huave dhe paradhënieve. Kreditë fshihen atëherë pasi janë ndërmarrur masa të arsyeshme të mbledhjeve në përpunje me politiken e përcaktuar të Bankës. Kur një ngjarje pasuese shkakton ulje të shumës së zhvlerësimit, ulja e humbjes nga zhvlerësimi rimerrët nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Pasuritë financiare të vlefshme për shitje të rëna në vlerë

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidence objektive që një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare janë të rëna në vlerë. Në rast të investimeve në kapital të klasifikuara për shitje, një rënie e ndjeshme ose e shtrirë në vlerën e drejtë të letrave me vlerë nën koston e tij është konsideruar në përcaktimin nëse pasuritë janë të rëna në vlerë ose jo. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston për pasuritë financiare për shitje, atëherë humbja kumulative e matur si diferençë mes kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi për pasurinë financiar e njohur më parë në fitim ose humbje, është hequr nga të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe njihet në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në fitim ose humbje në instrumentet e ekuititetit nuk kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes. Në qoftë se, në një periudhë vijuese, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit të klasifikuar si i vlefshëm për shitje tritet dhe tritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas humbjes nga zhvlerësimi, është njohur në fitim ose humbje. Humbja nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

g) Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj perfshijnë monedha dhe kartmonedha ne arkë, gjendja në Bankën Qendore, mjete këto të pakufizuara në përdorim dhe pasurive financiare shume likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

h) Letrat me vlerë të gatshme për shitje

Letrat me vlerë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit.

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative të cilat janë percaktuar si të vlefshme për shitje ose nuk janë klasifikuar si një kategori tjeter e pasurive financiare. Investimet e vlefshme për shitje përbëhen nga letrat me vlerë të borxhit. Të gjitha investimet e vlefshme për shitje janë matur me vlerën e drejtë, pas njohjes fillestare.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga këmbimi valutor në investimet e vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje (shih (f)(vii)).

Ndryshime tjera të vlerës së drejtë, përvëç humbjeve nga zhvlerësimi (shih (f)(vii)), njihen në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë brenda ekuititetit. Kur investimi shitet, fitimi ose humbja e akumuluar në ekuitet riklasifikohet në fitim ose humbje.

i) Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fiksese ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shes menjëherë apo në një periudhë afatshkurtër. Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë klasifikuar si kredi dhe të arkëtueshme.

Kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(*Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe*)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

j) Depozitat, huamarrjet dhe kreditë e varura

Depozitat, huamarrjet dhe kreditë e varura janë burimet kryesore të Bankës për financim. Depozitat, huamarrjet dhe kreditë e varura maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

k) Pasuritë e riposeduara

Pasuritë e riposeduara janë përfituar nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit për kreditë dhe paradhënet me probleme për klientët dhe që nuk fitojnë qira, nuk janë të përdorura nga Banka dhe janë të destinuara për shitje në një periudhë kohore të arsyeshme afatshkurtër. Pasuritë e riposeduara maten sipas vlerës më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje.

l) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur sipas kostos minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet nga dëmtimet.

Kosto historike përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Softueri i blerë që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata kanë jetëgjatesi të ndryshme, ato llogariten si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës dhe pajisjeve.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerra jashtë përdorimit të një zëri të pronës dhe pajisjeve (llogaritur si diferenca mes të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto të zërit), njihet në të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kostot pasuese kapitalizohen vetëm kur vërtetohet që përfitime ekonomike të ardhshme të atij shpenzimi do të rrjedhin në bankë. Riparimet e vazhdueshme dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në shpenzime në periudhën që kanë ndodhur.

(iii) Zhvlerësimi

Zërat e pronës dhe pajisjeve zhvlerësohen nga data kur ato janë të vlefshme për përdorim. Amortizimi llogaritet për të shlyer koston e artikujve të pronës dhe pajisjeve minus vlerat e përllogaritura të mbeturat të këtyre pasurive përgjate jetës së parashikuar të përdorimit. Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetëgjatësise së çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Jetëgjatesia për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

	Jetëgjatësia
Ndërtesa	20 vite
Kompjutera dhe pajisje të ngjashme	5 vite
Automjete	5 vite
Mobilje dhe pajisje	5 vite

Përmirësimet e objekteve me qera zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit gjatë afatit më të shkurtër të qerasë dhe të jetës së tyre të dobishme. Jetëgjatësia e përmirësimeve në objektet e marra me qera është 5 vite.

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlerat e mbeturat janë rivlerësuar në datën e raportimit dhe iregulluar atëherë kur duhet.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(*Shumat në '000 Euro, përveç nëse është cekur ndryshe*)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

m) Pasuritë e paprekshme

Softuerët e blerë nga Banka janë matur me kosto minus amortizimin e akumular dhe minus ndonjë humbje nga amortizimi. Shpenzimet pasuese mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike në asetin specifik më të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera njihen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së dobishme të pasurisë, që nga data që është i vlefshëm përdorim.

Softueri amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme për pesë vite. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

n) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të bankës, përveç pasurive për tatime të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose e njësise gjeneruese të mjeteve monetare të tij e tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostojë për shitje. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e të hollave të ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi për taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me pasurinë.

Humjet nga dëmtimi janë njohur në fitim apo humbje. Humbja nga rënia në vlerë kthehet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk është njohur humbja nga zhvlerësimi.

o) Provizonet

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, ku Banka ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi dhe ka mundësi që një dalje e mjeteve monetare do të kërkohet për të shlyer obligimin. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritura të pasurive monetare me një norme para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe sipas rastit, me rreziqet specifike të detyrimit. Skontimi i pashmangshëm njihet si kosto financiare.

p) Përfitimet e punonjësve

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuara të kontributeve për pensione.

(ii) Përfitimet afatshkurtëra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtëra të punëtoreve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime me momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar ketë vlerë si rezultat i sherbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi me ç'rast detyrimi mund të vlerësohet me saktësi.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(*Shumat në '000 Euro, përveç nëse është cekur ndryshe*)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

q) Garacionet financiare dhe zotimet për kreditë

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadھnës. Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të para-përcaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit finanziar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

r) Dividenda

Dividenda nga aksionet e zakonshme njihen në kapital në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividenda për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë paraqitur si ngjarje pas perfundimit të periudhës së raportimit.

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato që mund të janë relevante për Bankën janë paraqitur më poshtë. Banka nuk planifikon të miratojë këto standarde dhe ndryshime të hershme.

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e publikimit të pasqyrave financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

s) Rezervat e ekuitetit

Rezervat e regjistruar në ekuitet në pasqyrën e pozicionit finanziar të bankës përbëhen nga:

- Rezerva letrave me vlerë të gatshme për shitje, që përfshin ndryshimet në vlerën e drejtë të investimeve të gatshme për shitje;
- Rezerva tjetër e ekuitetit, që përfshin dallimin ndërmjet humbjeve të akumuluara sipas SNRF dhe BQK;
- Rezerva e rivlerësimit, që përfshin kolateralin e riposuar të regjistruar në pasuri dhe pajisje nga banka.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(*Shumat në '000 Euro, përvëç nëse është cekur ndryshe*)

4. ADAPTAMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMI I TYRE

4.1 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive

IFRS 9 Instrumentet Financiare

Në korrik të vitit 2014, IASB publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentet Financiare që zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet paraprake të SNRF 9. SNRF 9 bashkon të tre aspektet e kontabilitetit për projektin e instrumenteve financiare: klasifikimin dhe matjen, rënien në vlerë dhe kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018, ku lejohet aplikimi i më i hershëm. Përvëç kontabilitetit mbrojtës, kërkohet edhe zbatimi retrospektiv, por ofrimi i informacioneve krahasuese nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkosat në përgjithësi aplikohen në mënyrë prospektive, me disa përshtime të kufizuar.

Banka planifikon të miratojë e standardet e reja në datën e kërkuar të hyrjes në fuqi. Banka është në proces të kryerjes së një vlerësimi të nivelit të lartë të ndikimit për të tre aspektet e SNRF 9.

Vlerësimi paraprak është i bazuar në informacionin aktual dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve që rrjedhin nga analiza të mëtejshme të hollësishme ose informacione shtesë të arsyeshme që mund të vihen në dispozicion të Bankës në të ardhmen.

m) Klasifikimi dhe matja

Banka nuk pret ndonjë ndikim të konsiderueshëm në bilancin e gjendjes apo në ekuitet, me zbatimin e kërkosave të klasifikimit dhe matjes që dalin nga SNRF 9. Pritet të vazhdojë matjen në vlerë të drejtë të gjitha pasurive financiare që aktualisht mbahen në vlerë të drejtë.

Kreditë dhe të arkëtueshmet mbahen për të mbledhur rrjedhat kontraktuale të parasë dhe pritet të sjellin rrjedha të parasë që paraqesin vetëm pagesat e kryegjës dhe interesit, përvëç për kreditë e papaguara për të cilat banka do të përftojë rrjedhat e saj të parasë nga ekzekutimi i kolateraleve.

Në këtë mënyrë, banka pret që këto do të vazhdojnë të maten në kosto të amortizuar sipas SNRF 9. Megjithatë, banka do të analizojë karakteristikat e flukseve monetare të këtyre instrumenteve në mënyrë më të detajuar para se të vijë në përfundimin se të gjitha këto instrumente plotësojnë kriteret për matje të kostos së amortizuar sipas SNRF 9.

n) Dëmtimet

SNRF 9 kërkon që Banka të regjistrojë humbjet e pritshme të kredisë në të gjitha letrat me vlerë të borxhit të saj, kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare, qoftë në baza 12-mujore ose përgjatë gjithë ekzistencës. Banka do të duhet të kryejë një analizë më të detajuar e cila konsideron të gjithë informacionin arsyeshëm dhe të mbështetur, duke përfshirë elementët e ardhshëm për të përcaktuar shkallën e ndikimit, për të vlerësuar ndikimin e plotë të standardit të ri.

o) Kontabiliteti mbrojtës

Banka beson që të gjitha raportet ekzistuese të mbrojtjes që aktualisht janë të përcaktuara në raportet efektive të mbrojtjes akoma do të kualifikohen për kontabilitet mbrojtës sipas SNRF 9. Pasi që SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme mbi atë se si një subjekt kontabilizon mbrojtjet efektive, banka nuk pret ndikim të konsiderueshëm si rezultat i aplikimit të SNRF 9.

SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 është publikuar në maj të vitit 2014 dhe vendos një model pesë-hapësh për të kontabilizuar të hyrat që shfaqen nga kontratat me klientët. Sipas SNRF 15, të hyrat njihen në një shumë që reflekton konsideratën (shumën) në të cilën subjekti pritet të marrë të drejtë, si shkëmbim për transferin e mallrave apo shërbimeve tek një klient.

Standardi i ri i të hyrave do të zëvendësojë të gjitha kërkosat aktuale për njohjen e të hyrave sipas SNRF. Për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018, kërkohet ose zbatimi i plotë retrospektiv ose zbatimi i modifikuar retrospektiv, kur BNSK finalizon ndryshimet e tyre për të shtyrë datën e hyrjes në fuqi të SNRF 15 për një vit. Miratimi i hershëm është i lejuar. Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga SNRF 15.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(Shumat në '000 Euro, përvëç nëse është cekur ndryshe)

4. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMI I TYRE (VAZHDIM)**4.1 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive (vazhdim)****SNK 7 Iniciativa e Shpalosjes – Ndryshimet në SNK 7**

Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë janë pjesë e Iniciativës së Shpalosjes së BSNK dhe kërkijnë që një subjekt të ofrojë shpalosje që iu mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare që të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që dalin nga aktivitetet financuese, përfshirë si ndryshimet që dalin nga rrjedhat e parasë ashtu dhe ndryshimet jo në para. Në zbatimin fillestar të ndryshimit, subjekteve nuk u kërkohet që të ofrojnë informacione krahasuese për periudhat paraprake. Këto ndryshime janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2017, ku lejohet aplikimi më i hershëm.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar të vitit 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë. KIRFN 4 përcakton nëse një marrëveshje përban një marrëveshje qiraje. KIS-15 Qeratë Operative- Nxitjet dhe KIS 27 Vlerësimi i Përbajtjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpalosjen e qirave. Gjithashtu kërkon nga qiramarrësit të jasin llogari për të gjitha qiratët në një model të vetëm në bilancin e gjendjes të ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy sqarime për qiratë-qiraja “me vlerë të ulët” (psh. kompjuter), dhe qiraja “afat-shkurtër” (qiratë me afat 12 muaj ose më pak).

Në ditën e marrëvshjes për qera, qiramarrësi do të njohë detyrimin për pagesë të qirasë (detyrimi për qira) dhe një pasuri që paraqet të drejtën për shfrytëzimin e qirasë për përiudhën kohore të përcaktuar në kontratë (p.sh., e drejta e përdorimit të pasurisë). Qiramarrësi do t'i kërkohet të njohë veçmas shpenzimet e interesit mbi qiranë dhe shpenzimet e amortizimit për të drejtën e përdorimit të pasurisë.

Qiramarrësit gjithashtu kërkohen të ri-matin detyrimin e qirasë pas ndodhjes së ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që rezultojnë nga ndryshimi në një indeks apo normë të përdorur për përcaktimin e pagesave të tillë). Qiramarrësi do të njoh në përgjithësi shumën e ri-matjes të detyrit të qirasë si një përshtatje në të drejtën për shfrytëzimin e pasurisë.

Kontabiliteti i qiradhënsit sipas SNRF 16 është në thelb pandryshuar nga kontabilitetin i sotëm sipas SNK 17. Qiradhënsi do të vazhdojë që të klasifikojë të gjitha qiratë duke përdorur të njëjtin parim të klasifikimit si në SNK 17 dhe dallon dy lloje të qirave: qira operative dhe financiare. SNRF 16 gjithashtu kërkon nga qiramarrësit dhe qiradhënsit që të bëjnë më shumë shpalosje se sa sipas SNK 17.

SNRF 16 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2019. Lejohet zbatimi më i hershëm, por jo para se një subjekt të zbatojë SNRF 15. Qiramarrësi mund të zgjedh që të zbatojë standardin duke përdorur qoftë një qasje të plotë retrospektive apo qasje të modifikuar retrospektive. Dispozitat kalimtare të përfshira në standard lejojnë lehtësimet e caktuara. Në vitin 2017, Banka planifikon të vlerësojë efektet e mundshme të SNRF 16 në pasqyrat e saj financiare.

Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38: Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit

Amendmentet sqarojnë parimin në SNK 16 dhe SNK 38 se të ardhurat pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që krijohen nga operimi i një biznesi (te të cilat aktivi është pjesë përbërëse) dhe jo nga përfitimet ekonomike që konsumohen nëpërmjet përdorimit të aktivit. Si rezultat, një metodë e bazuar në të ardhura nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar pronën, impiantet dhe pajisjet dhe mund të përdoret vetëm në rrethana shumë të kufizuar për të amortizuar pasurite jo-materiale. Ndryshimet janë efektive në mënyrë prospективë për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me lejen e hershme të lejuar. Këto ndryshime nuk priten të kenë ndonjë ndikim në Bankë, duke qenë se Banka nuk ka përdorur një metodë të bazuar në të ardhura për të zhvlerësuar asetet e saj jo qarkulluese.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe)

4. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMI I TYRE (VAZHDIM)**4.2 Standardet dhe interpretimet e reja apo rishikuara****Përmirësimet vjetore 2012-2014 Cikli**

Këto përmirësimë janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. Ato përfshijnë:

SNRF 5 Pasuritë Jo - qarkulluese që mbahen për shitje dhe operacionet e ndërprera

Pasuritë (ose grupet e tjeterësuara) në përgjithësi asgjësohen përmes shitjes ose shpërndarjes tek pronarët. Ndryshimi sqaron se ndërimi nga njëra prej këtyre metodave të tjeterësimit e tek tjera nuk do të konsiderohet si një plan i ri i tjeterësimit, por më tepër konsiderohet si një vazhdim i planit fillestar.

SNRF 7 Instrumentet Financiare: Shpalosjet**(i) Kontratat e shërbimit**

Ndryshimi sqaron se një kontratë e shërbimeve që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme në një pasuri financiare. Një kompani duhet të vlerësojë natyrën e tarifës dhe dhe rregullimi kundër udhëzimit të përfshirjes së vazhdueshme në SNRF 7 në mënyrë që të vlerësohet nëse shpalosjet e informacione shpjeguese janë të nevojshme. Vlerësimi se cilat kontrata të shërbimeve përbëjnë përfshirje të vazhdueshme duhet të bëhet në mënyrë retrospektive. Megjithatë, shpalosjet e kërkua nuk do të duhet të sigurohen për çdo periudhë që fillon para periudhës vjetore në të cilën kompania i zbaton ndryshimet së pari.

(ii) Zbatimi i ndryshimeve të SNRF 7 për Pasqyrat e Ndërmjetme Financiare të Konsoliduara

Ndryshimi sqaron se kërkesat kompensuese për dhënie informacionesh shpjeguese nuk zbatohen për pasqyrat e konsoliduara financiare, përvèç nëse dhëni/ shpalosjet e tillë sigurojnë një përditësim të konsiderueshmë në informacionin e reportuar në raportin më të fundit vjetor. Banka nuk i përgatitë pasqyrat e ndërmjetme të konsoliduara.

Ndryshimet në SNK 1 Iniciativa për dhënie të informacioneve shpjeguese/shpalosje

Ndryshimet në SNK 1 sraqojnë, më shumë se sa ndryshimet e konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:

- Kërkesat e materialitetit në SNK 1
- Se zërat e linjave specifike në pasqyrën/pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe ardhurave tjera gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar (bilanci) mund të ndahen/disagregohen
- Se subjektit kanë fleksibilitet sa i përkërt rendit në të cilin i paraqesin shënimet për pasqyrat financiare
- Se pjesa e ATGJ-së së pjesëm dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit duhet të paraqiten në total si një zë i linjës së vetme, dhe të klasifikohen mes atyre zërave që do të klasifikohen apo jo më pastaj në fitim ose humbje.

Për më tepër, ndryshimet qartësojë kërkesat që aplikohen kur nën-totalet shtesë paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën/pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe ATGJ-së. Këto ndryshime nuk kanë ndonjë ndikim në Bankë.

SNK 19 Përfitimet e Punonjësve

Ndryshimi sqaron se thellësia e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, se vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, normat e bonove qeveritare duhet të përdoren.

Standarde të tjera që janë lëshuar ose rishikuar kohët e fundit por të cilat nuk janë të zbatueshme për Bankën përfshijnë:

- SNK 34 Raportimi Financiar për Interim;
- SNRF 14 Kontot e Shtyra të Rëgullatorit;
- Ndryshimet në SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta: Kontabiliteti për marrjen e interesave;
- Ndryshimet në SNK 27 Metoda e Ekuititetit në Pasqyrat e Veçanta Financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(Shumat në '000 Euro, përveç nëse është cekur ndryshe)

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Menaxhmenti diskuton me Komitetin e Auditimit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël kritike të Bankës dhe zbatimin e tyre si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë e mëdha të vlerësimit. Informacioni në lidhje me supozimet dhe vlerësimet e pasigurive që kanë një rrezik të rëndësishëm të rezultojnë në një rregullim material brenda vitit të ardhshës financiar dhe përgjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta janë shpalosur më poshtë. Këto shënimë shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e riskut financiar (shih shënimin 25).

a) Dëmtimi

Pasuritë e llogaritura me kosto të amortizuar vlerësohen për zhvlerësimin në bazë të politikave të përshkruara të kontabilitetit në shënimin 3 (f) (vii).

Banka rishikon portofolian e saj të kredive për të vlerësuar zhvlerësimin në baza të rregullta. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave apo jo, Banka bënë gjykimë nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënje të matshme në flukset e ardhshme të parashë nga portofolio e kredive para se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale në atë portfolio. Kjo evidencë mund të perfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup, apo në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mungesa në pasurite e Bankës.

Menaxhmenti përdor vlerësimë të bazuara në përvojen historike të humbjeve për pasurite me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe prova objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofolio kur bëhet caktimi i flukseve të ardhshme të parashë. Metodologja dhe supozimet e përdorura për zhvlerësimin e shumës dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohet rregullisht për të zgjeluar ndonjë diferençë midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvjetorët aktuale të humbjes.

Banka përcakton se investimet e vlefshme për shitjet zhvlerësohen kur ka një rënje të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre. Ky përcaktim se çfarë është e rëndësishme ose e shtyrë, kërkon një gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson në mesin e faktorëve të tjera, paqëndrueshmërinë normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm, kur ka prova të përketësimit në shëndetin financiar të të investuarit, pëformancës së industrisë dhe të sektorit, ndryshimet në teknologji dhe flukset operative dhe të financimit të rrjedhës së parave.

b) Vlera neto e realizuar e pasurive të riposeduara

Banka ka krijuar një politikë në lidhje me vlerat e drejta të pasurive të riposeduara të cilat janë duke u matur me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizuar. Matja e vlerës së drejtë përfshin përdorimin e vlerësimëve të pavarura të jashtme të pronës, nga një vlerësues që ka kualifikimet e duhura ligjore profesionale, e cila më pas është shqyrtuar nga Menaxhmenti i Bankës për inputet e rëndësishme jo të dukshme dhe ndonjë rregullim i nevojshëm për shlyerje.

Banka nuk mban pronat e riposeduara në pasqyrën e pozicionit financiar për periudhë më të gjatë se 5 vite. Vlerat e drejta të pasurive të riposeduara të Bankës janë të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtës.

Teknikat e vlerësimit dhe inputet e rëndësishme jo të vëzhgueshme

Tabela e mëposhtme tregon teknikën e vlerësimit të përdorur në matjen e vlerës së drejtës si dhe përdorimin e inputeve të rëndësishme të pavëzhgueshme.

Teknikat e vlerësimit

Referencë në tregun aktual:
Modeli i vlerësimit përdor çmimet dhe informacione të tjera të gjeneruara nga transaksionet e tregut duke përfshirë asetat identike ose të krahasueshme, detyrimet, ose një grup të pasurive dhe detyrimet (p.sh. një biznes)

Inputet e rëndësishme të pavëzhgueshme

Çmimet e tregut janë modifikuar për të pasqyruar:
• nivelin e transaksioneve të tregut, kur aktiviteti i tregut është i ulët ose çmimi për një pronë të njëjtë është i veshtirë për tu marrë;
• gjendja specifike e secilës pronë (ndërtim, pozita etj.).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe)

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE**a) Përcaktimi i vlerës të drejtë**

Përcaktimi i vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmim tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshtruhet në shënimin 3. (f). (vi). Për instrumentët financiar që tregtohen rralë dhe kanë pak transparencë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasurisë së faktorëve të tregut, supozimeve rrëth çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë në instrumentin specifik. Banka vlerëson vlerën e drejtë duke shfrytëzuar hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmim i kuotuar i tregut në tregje aktive për instrumentet identike;
- Niveli 2: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të vlerësueshme. Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuara duke shfrytëzuar: çmimet e tregut për instrumente të ngashme në tregjet aktive; çmimet e tregut për instrumente të ngashme në tregjet më pak aktive; apo teknika tjera të vlerësimit në të cilat të gjithë faktorët material në menyrë direkte apo indirekte janë të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut;
- Niveli 3: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentët për të cilët teknikat e vlerësimit përfshijnë faktor që nuk bazohen në të dhëna të vezhgueshme dhe faktorët e pavëzhgueshem kanë një ndikim material në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumentet që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të tregut për instrumente të ngashme për të cilat rregullime apo gjykime materiale jo të vëzhgueshme kërkohen për të reflektoar dallimet mes instrumenteve.

Vlerësimi i vlerës së drejtë është shpalosur në shënimin 5 d) më poshtë.

(d) Paraqitura dhe vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në instrumentë financiar në pasqyrën ekzistuese të pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e pasurive dhe datyrimeve që nuk konsiderohen instrumentë financiar.

Instrumentët financiar - Hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme tregon vlerën e drejtë të instrumenteve financiar të matura dhe jo të matura me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilin është kategorizuar secila matje me vlerën e drejtë.

	2016		2015	
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Nivel 2
Pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë				
Të vlefshme për shitje	18,267	18,267	10,372	10,372
Pasuritë financiare jo të matura sipas vlerës së drejtë				
Paraja e gatshme dhe në banka	39,939	39,939	33,199	33,199
Kredi dhe paradhënie për banka	600	600	960	960
Kredi dhe paradhënie për klientet	103,149	106,645	87,025	89,974
Pasuritë tjera financiare	237	237	291	291
Detyrimet financiare jo të matura sipas vlerës së drejtë				
Detyrime ndaj klienteve	140,598	141,101	115,848	116,330
Borxhet e varura	1,845	1,839	1,848	1,842
Huamarrjet	4,248	3,620	3,017	3,017
Detyrimet tjera financiare	1,346	1,346	651	651

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(Shumat në '000 Euro, përvëç nëse është cekur ndryshe)

4. PARAQITJA DHE VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË (VAZHDIM)

(d) Paraqitja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Instrumentët finansiar - Hierarkia e vlerës së drejtë (vazhdim)

Vlerat e drejta për pasuritë dhe detyrimet financiare të mësiperme janë përcaktuar duke përdorur nivelin 2 të dhënav të përshkruara më lartë.

lerësimet e vlerave reale bazohen në instrumente ekzistuese financiare në pasqyren e pozicionit finansiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta finansiar.

Llogaritë me bankat

Llogaritë nga bankat e tjera përfshijnë plasmanet ndërbankare. Përderisa kreditë, paradhënet dhe depozitat janë afatshkurtëra dhe me norma të ndryshueshme, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Bonot e thesarit

Bonot e thesarit perfshijnë bono të emetuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat janë blerë me qëllim për t'i mbajtur deri në maturitet. Vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të aktualizimit të fluksit të parave bazuar në një lakore aktuale të kthimit të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim.

Obligacionet

Obligacionet janë obligacione të emetuara nga Qeveria e Kosovës, te cilat janë blerë me qëllim për tu mbajtur deri në maturitet. Çmimet e kuotuara në tregjet aktive nuk ishin të vlefshme për këto letra me vlerë. Megjithatë, ka pasur informacione të mjaftueshme të vlefshme për të matur vlerat e drejta të këtyre letrave me vlerë në bazë të inputeve të vëzhgueshme të tregut.

Kreditë dhe paradhënet për klientët

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhënieve është e bazuar në transaksionet e vëzhgueshme të tregut. Kur transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur metodat e vlerësimit, të tilla si teknikat e fluksit monetar të aktualizuar. Teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme të kredisë, normat e interesit dhe normat e parapagimit.

Kreditë dhe paradhënet për klientët

Për të pëmirësuar saktësinë e vlerësimit të kredive tregtare dhe të bizneseve të vogla, kreditë homogjene grupohen në portofolio me karakteristika të ngjashme.

Portofolio i kredive të Bankës ka një vlerë të drejtë të vlerësuar afersisht si e barabartë me vlerën e tij kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave të interesit të cilat përafrojnë me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolios të kredive është subjekt i ndryshimit të çmimeve brenda një viti.

Detyrimet ndaj klientëve, huamarrjet dhe borxhet e varura

Vlera e drejtë e borxhit të varur, huave dhe detyrimeve ndaj klientëve janë vlerësuar duke përdorur teknika të aktualizimit të rrjedhës së parasë, duke zbatuar normat që janë ofruar për depozitat dhe për borxin e varur me maturitet dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkësës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(*Shumat në '000 Euro, përvç nëse është cekur ndryshe*)

6. TË ARDHURAT NETO NGA INTERESI

Të ardhurat neto nga interesi përbëhen si në vijim:

	2016	2015
Të ardhurat nga interesi:		
Kredi dhe paradhënie për klientët	9,716	9,018
Kredi dhe paradhënie për bankat	7	2
Investimet e mbajtura deri në maturitet	98	153
Investimet e vlefshme për shitje	9,821	9,173
Shpenzimet e interesit:		
Depozitat nga klientët	(1,347)	(1,466)
Borxhet varura	(203)	(186)
Huamarrjet	(120)	(17)
	(1,670)	(1,669)
Të ardhurat neto nga interesi	8,151	7,504

7. TË ARDHURAT NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	2016	2015
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		
Transfere pagesash dhe transaksione	1,525	1,485
Tarifat e mërmëbajtjes së llogarive	433	321
Tarifa dhe komisione tjera	42	42
	2,000	1,848
Gjithsej të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet		
Tarifat dhe komisionet nga llogaritë bankare	(422)	(323)
Tarifat dhe komisionet nga shpërndarja e ndihmave sociale	(49)	(69)
Tarifa dhe komisione tjera	(51)	(22)
	(522)	(414)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	1,478	1,434

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(Shumat në '000 Euro, përveç nëse është cekur ndryshe)

8. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	2016	2015
Shpenzimet e personelit (shih më poshtë)	2,717	2,388
Qeratë	623	667
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	398	368
Sigurimi dhe siguria fizike	290	303
Shërbimet komunale dhe karburanti	168	162
Riparimet dhe mirëmbajtja	148	152
Komunikimi	137	135
Konsulencia	74	87
Shpenzimet ligjore	196	131
Shpenzimet e procesimit të kartelave	190	131
Shpenzimet e marketingut dhe reklamimit	161	170
Shpenzimet e pastrimit	42	39
Materialet për zyrë	54	49
Shpenzimet e anëtarëve të bordit	42	42
Udhëtimi	15	12
Shpenzime tjera	367	413
Gjithsej	5,622	5,249

Numri i të punësuarve me 31 dhjetor 2016 është 327 (31 dhjetor 2015: 288).

Shpenzimet e personelit përbëhen si me poshtë:

	2016	2015
Pagat dhe meditjet	2,323	2,111
Kontributi pensional	119	104
Përfitimet sekondare	250	163
Kompensime tjera	25	10
Gjithsej	2,717	2,388

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(*Shumat në '000 Euro, përvëç nëse është cekur ndryshe*)

9. TATIMI NË FITIM

Ngarkesa e tatimit në fitim ndryshon nga shuma teorike që do të krijohej duke përdorur normën mesatare të ponderuar të tativeve të zbatueshme për fitimet e Bankës si më poshtë:

	Norma Efektive e interesit		Norma Efektive e interesit	
	2016	2015	2016	2015
Fitimi para tatimit				
Tatimi i llogaritur me 10%	10%	453	10%	200
Rregullimi nga provizionet e ndryshme për kreditë bazuar në rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës.	-	-	-	-
Rregullimi për zhvlerësimin në pasuritë e riposeduara	-	-	-	-
Efekti ër shpenzimet e pazbritshme tatumore	-	-	0.05%	1
Efekti i panjohur i tatimit për interesin aktual në depozita	0.44%	20	(1.00%)	(20)
Shfrytëzimi i humbjeve tatumore të bartura përpara	(1.92)	(87)	(9.05%)	(181)
Tatimi ne fitim	-	387	-	-

Tatimi i shtyrë është kalkular me normën prej 10%. Pasuritë nga të hyrat e shtyera tatumore janë njojur vetëm deri në masën që realizimi i përfitimit tatimor është i mundshëm. Më 31 dhjetor 2016, pasuritë nga të hyrat e shtyera tatumore, neto në shumën prej zero mijë Euro (2015: 87 mijë Euro) nuk janë njojur si diferençë neto e përkohshme për shkak të pasigurisë që fitimet e tatushme të mjaftueshme do të janë të vlefshme për të lejuar që të shfrytëzohen në dobi të kësaj pasurie tatumore të shtyrë.

	2016	2015
Detyrimi në fillim	105	105
Shtesat gjatë vitit	387	-
Pagesat gjatë vitit	(290)	-
Detyrimi në fund	202	105

Periudha për bartjen e humbjeve tatumore në pajtim me Ligjin mbi Tatimin në Kosovë është gjashtë vite. Tatimi në fitim vlerësohet me normën 10% (2015:10%) nga të ardhurat e tatushme: Tabela në vijim paraqet harmonizimin ndërmjet fitimit kontabël dhe tatimit ne fitim:

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Humbjet sipas tativeve të paregjistruarë gjatë vitit	167	1,160	2,232	(87)	(789)	(1,814)	(869)
Humbjet tatumore të bartura përpara	167	1,327	3,559	3,472	2,683	869	-

	2015	Lëvizjet gjatë 2016	2016
Humbjet tatumore të bartura përpara	(869)	869	-
Tatimi i shtyrë me 10%	87	(87)	-
Minus: Humbjet sipas tativeve të paregjistruarë	(87)	87	-
Tatimi i shtyrë në fund të vitit	-	-	-

	2015	Lëvizjet gjatë 2016	2016
Provizonet për kreditë e rëna në vlerë	105	21	126
Detyrimi për tatimin e shtyrë në fund të vitit	105	21	126

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(*Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe*)

10. PARAJA E GATSHME DHE NË BANKA

	2016	2015
Paraja e gatshme	5,743	6,335
Paraja në banka	6,948	4,288
Gjithsej	12,691	10,623

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen si në vijim:

	2016	2015
Paraja e gatshme dhe në banka	12,691	10,623
Shumat tjera në BQK (shënimi 11)	14,955	13,531
Gjithsej	27,646	24,154

11. GJENDJA ME BANKËN QENDRORE TË KOSOVËS

	2016	2015
Rezervat e detyrueshme	12,293	9,045
Llogaria rrijedhëse	14,955	13,531
Gjithsej	27,248	22,576

Në përpunje me kërkasat e BQK-së në lidhje me rezervën e depozitave për qëllime të likuiditetit, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve me maturitet deri në një vit, si rezerva të detyrueshme. Rezervat e detyrueshme duhet të përfaqësojne instrumente me likuiditet të lartë, duke përfshirë para të gatshme, llogaritë në BQK, ose në bankat tjera në Kosovë, si dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të janë më pak së gjysma e totalit të rezervave. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkasat e likuiditetit janë depozitat në Euro me BQK-në dhe 50% e ekuivalenjtë në Euro të parave të gatshme në valuta lehtësish të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të janë më pak se 5% e bazës së depozitave të aplikueshme.

12. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR BANKAT

	2016	2015
Llogaritë e billokuara	600	960
Raiffeisen Bank International	600	960
Gjithsej	600	960

Kreditë dhe paradhëni të parë të bankave përfshijnë llogaritë e billokuara në emër të garacioneve të klientëve.

13. PASURITË FINANCIARE TË VLEFSHME PËR SHITJE

	2016	2015
Letrat me vlerë	10,720	5,334
Bondet qeveritare	7,547	5,038
Gjithsej	18,267	10,372

Gjatë vitit 2016, Banka ka shitur rreth 14 instrumentë financiare. Instrumentët financiarë u shitën me çmim më të lartë në krahasim me çmimin e blerjes. Blerësi i vetëm i instrumenteve financiarë ishte Banka Qendrore e Kosovës. Fitimi u njoh në pasqyrën e të ardhurave në shumë prej 1,878 mijë Euro.

Gjatë vitit 2015, Banka ka shitur investime të mbajtura deri në maturitet prej 6,034 mijë Euro. Si rezultat, e gjithë portofolio i investimeve të mbajtura deri në maturitet u ndryshua dhe u riklasifikua në pasuri financiare të vlefshme për shitje.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe)

14. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT

Kreditë dhe paradhëni për klientë përbëhen si në vijim:

	2016	2015
Kreditë dhe paradhëni për klientët	107,904	91,380
Interesi akrual	561	534
Tarifat e shtyra të disbursimit	(649)	(474)
Gjithsej	107,816	91,440
Provizonet kreditë e rëna në vlerë për klientët	(4,667)	(4,415)
Kreditë dhe paradhëni neto të klientëve	103,149	87,025

Lëvizjet në provizionet për kreditë e rëna në vlerë janë si në vijim:

	2016	2015
Më 1 janar	4,415	5,075
Provizioni për humbjet nga kreditë	830	1,584
Kreditë e shlyera	(578)	(2,244)
Më 31 dhjetor	4,667	4,415

Banka ka tejkaloar kufirin e përcaktuar nga BQK-ja për eksposimin maksimal ndaj kapitalit të klasit të parë në lidhje me një klient apo një grup të klientëve të lidhur për një rast me 31 dhjetor 2014, për të cilin banka ka marr aprovim nga BQK-ja deri më 30 qershor 2015. Banka nuk i ka kaluar kufijtë e tillë më 31 dhjetor 2015 dhe 2016.

Banka menaxhon eksposimet individuale të palëve në mënyrë që të jetë në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore që kërkojnë eksposimet individuale kundrejt një pale të mos tejkalojnë 15% të Kapitalit Tier I (ose 14,512 mijë Euro).

Më 31 dhjetor 2016 nuk ka eksposime kundrejt një pale mbi 15% të limitit. Përvèç kësaj, eksposimi kumulativ i 10 klientëve kryesor të bankës është 9,757 mijë Euro (2015: 9,612 mijë Euro).

Një barazim i lejimit për humbjet nga zhvlerësimi për huatë dhe paradhëni, sipas klasës, është si më poshtë :

	2016			2015		
	Korporata	Retail	Total	Korporata	Retail	Gjithsej
Me 1 Janar 2016	3,885	530	4,415	4,570	505	5,075
Ngarkesa për vitin	667	163	830	1,559	25	1,584
Shumat e shlyera	(578)	-	(578)	(2,244)	-	(2,244)
Me 31 Dhjetor 2016	3,974	693	4,667	3,885	530	4,415

15. PASURI TJERA FINANCIARE

	2016	2015
Shpenzimet e parapaguara	14	133
Të hyrat e shtyera nga shërbimet bankare	84	67
Tarifat dhe komisionet e shtyera	55	84
Të arkëtueshmet nga garacionet	70	-
Kërkesa tjera	14	7
Gjithsej	237	291

16. MJETE TJERA

	2016	2015
Shpenzime të parapaguara	141	122
Total	141	122

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
(Shumat në '000 Euro, përvèç nëse është cekur ndryshe)

17. MJETET E RIPOSEDUARA

	2016	2015
Pasuritë e patundshme banesore	572	572
Pasuritë e patundshme komerciale	1,688	1,008
Gjithsej	2,260	1,580
Minus: rënia në vlerë	(1,362)	(833)
Vlera neto kontabël	898	747

Vlera e drejtë e këtyre pasurive është përcaktuar duke iu referuar vlerave të tregut nga ana e vlerësuesit të jashtëm të pavarur. Vlerat janë provisionuar në varësi të vendndodhjes së tyre, mirëmbajtjes, kushteve dhe rrethanave që pasqyrojnë vonesat e mundshme në shitjen e tyre dhe gjatësine e kohës përmajtjen e pasurive.

Lëvizjet në zhvlerësimin e pasurive janë si në vijim:

	2016	2015
Më 1 janar	833	528
Provizioni për zhvlerësim gjatë vitit	529	305
Kthimet nga shitjet/heqjet	-	-
Më 31 dhjetor	1,362	833

18. PASURITË E PAPREKSHME

	Programe kompjuterike
Kosto	
Gjendja më 1 Janar 2015	805
Shtesat gjatë vitit	89
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	894
Shtesat gjatë vitit	156
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	1,050
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja më 1 Janar 2015	660
Shpenzimi përvit	87
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	747
Shpenzimi përvit	77
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	824
Vlera kontabël	
Gjendja më 31 dhjetor 2015	147
Gjendja më 31 dhjetor 2016	226

Banka për Biznes Sh.a.
Shënime për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016
(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse shprehët ndryshe)

19. PRONA DHE PAJISJET

	Përmirësimë në objektet me qira	Mobiljet dhe orenditë	Kompjuterët dhe pajisje të ngashme	Automjetet	Gjithsej
Kosto					
Më 1 janar 2015	109	610	574	1,181	489
Shtesat gjatë vitit	-	275	101	177	158
Pakësimet gjatë vitit	-	(111)	(130)	(178)	(50)
Më 31 dhjetor 2015	109	774	545	1,180	597
Shtesat gjatë vitit	-	71	19	113	73
Shlyerjet gjatë vitit	(13)	(18)	(79)	(13)	(17)
Më 31 dhjetor 2016	96	827	485	1,280	653
Zhvlerësimi i akumuluar					
Më 1 janar 2015	13	507	495	962	344
Shpenzimi për vitin	2	62	75	84	58
Shlyerjet gjatë vitit	-	(108)	(129)	(173)	(28)
Më 31 dhjetor 2015	15	461	441	873	374
Shpenzimi për vitin	2	90	42	94	93
Shlyerjet gjatë vitit	(13)	(16)	(21)	(24)	(50)
Më 31 dhjetor 2016	4	535	462	943	417
Vlera kontabel					
Më 31 dhjetor 2015	94	313	104	307	223
Më 31 dhjetor 2016	92	292	23	337	236
					980

Më 31 Dhjetor 2016 Banka nuk ka ndonjë pronë të deklaruar si peng.

Në kuadër të pronave dhe pajisjeve me 31 dhjetor 2016 ka ndërtesa me vlerë 92 mijë Euro (2015: 94 mijë Euro) të riposeduara si kolateral dhe që menaxhmenti i shfrytëzon për aktivitetet e përditshme të Bankës.

Në vijim janë disa zëra të pasurive dhe pajisjeve të cilat janë zhvlerësuar plotësisht por që janë ende në shfrytëzim më 31 dhjetor 2016:

Kategoria	Kosto	Zhvlerësimi i akumuluar	Vlera Neto
Ndërtesa	9	9	-
Përmiresimet në objekte me qera	420	420	-
Mobilje dhe orendi	474	474	-
Kompjuterë dhe pajisje të ngashme	647	647	-
Vetura	143	143	-
Softuerë	618	618	-
Gjithsej	2,311	2,311	-

Banka për Biznes Sh.a.
Shënime për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016
(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

20. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE

	2016	2015
Llogaritë rrjedhëse	60,214	50,036
Në Euro	58,565	47,625
Në valuta të huaja	1,649	2,411
Depozitat e afatizuara	80,384	65,812
Në Euro	78,388	65,084
Në valuta të huaja	1,996	728
Gjithsej	140,598	115,848

21. KREDITË E VARURA DHE HUAMARRJET

	2016	2015
Kreditë e varura		
BERZH	1,005	1,008
<i>Individët:</i>		
Valon Budima	420	420
Armend Skeja	420	420
	1,845	1,848

Kreditë e varura janë dhënë nga palët e mësiperme për ti lejuar Bankës të mbajë nivelet minimale të kapitalit rregullator dhe bartin një normë vjetore interesë prej 10%. Interesi për BERZH është i pagueshëm në baza tremujore, ndërsa intereseti për individët është i pagueshëm në baza vjetore. Borxhet e varura janë të pagueshme në datat e mëposhtme:

- Kredia nga BERZH: 31 korrik 2019.
- Kredia nga individët: 26 dhjetor 2023.

Kreditë e varura nga individët nuk kanë kushte të veçanta të bashkangjitura me marrëveshje. Banka nuk ka qenë në përputhje me konventat e caktuara financiare të bashkengjitura të marrëveshjes me BERZH. Më 31 dhjetor 2015, Banka nuk ka qene në përputhje si me poshtë:

- Mbajtja e një raporti të pasurive likuide ndaj depozitave 75% ose me shumë;
- Mbajtja e hendekut negativ të likuiditetit në lidhje me çdo grup maturimi jo më shumë se 20% në çdo kohë;
- Mbajtja e një norme të ekspozimit të hapur të kreditimit jo më shumë se 12%;
- Mbajtja e ekspozimit për 10 huamarrësit më të mëdhenj sipas nivelit të kredive të tyre me pjesëmarrje në portofolion kreditore jo më shumë se 10%.

Huamarrjet

	2016	2015
Huamarrja nga FEEJ	3,240	3,017
Humarrja nga BERZH	1,008	-
Gjithsej	4,248	3,017

Gjatë vitit 2016, Banka ka hyrë në një marrëveshje huamarrëse me BERZH (Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) për një total prej 1,000 mijë Euro. Qëllimi është për të mbështetur individët privat dhe portofolion e kredive të NVM-ve në lidhje me programin e efikasitetit të energjisë. Huamarrja bartë një normë interesë vjetor prej 3.6%, dhe është e pagueshme brenda pesë viteve. Interesi është i pagueshëm në baza tremujore.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016

(Shumat janë në mijë Euro, përvçë nëse shprehet ndryshe)

21. KREDITË E VARURA DHE HUAMARRJET (VAZHDIM)

Gjatë vitit 2015, Banka nënshkruajti një marrëveshje huazimi me FEEJ (Fondi Evropian për Evropën Juglindore) për një total prej 4,000 mijë Euro. Qëlliimi është të mbështesë individët privat dhe portofoliot e kredive për NVM-të. Një shumë prej 1,000 Euro nuk ishte arkëtuar ende më 31 dhjetor 2015. Huamarrja bartë një normë interesë prej 3.4% në vit dhe paguhet brenda tre vjetëve. Interesi paguhet në baza tremujore.

22. DETYRIME DHE PROVIZIONE TJERA

	2016	2015
Pagesat në tranzit	593	295
Provizonet për letër garacionet e lëshuara nga Banka	-	52
Të pagueshmet në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale	450	170
Të pagueshmet në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	78	25
Detyrime ndaj furnitorëve	225	161
Gjithsej detyrime tjera	1,346	703
Provizione tjera (shiko shënimin më poshtë)	404	642
Gjithsej	1,750	1,345

Banka vepron si agjent për transakzionet e kryera në emër të institucioneve qeveritare me palët e tretë. Kjo përfshin pagesat në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Provizonet e tjera përsaqësojnë një provizion të krijuar për çështje ligjore kundrejt aksionarëve të mëparshëm të Bankës. Pala e tretë ka fituar kontestin gjyqësor gjatë vitit 2015, dhe ka shumë mundësi që edhe Gjykata Supreme ta konfirmojë vendimin. Vlera e kontestit ka qenë 642 mijë Euro dhe e gjithë shuma është parevizonuar më 31 dhjetor 2015.

Në vijim është paraqitur lëvizja në provizione më 31 dhjetor:

	2016	2015
Në fillim të vitit	642	-
Shtesat gjatë vitit	622	642
Të shfrytëzuara gjatë vitit	(860)	-
Në fund të vitit	404	642

23. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT**Kapitali aksionar**

Në pajtim me Ligjin nr. 04/L-093 për “Banka, Institucione Microfinanciare dhe Institucione Financiare Jo-Bankare”, kapitali aksionar minimal për bankat që operojnë në Kosovë duhet të jetë 7 milion Euro.

Me 31 dhjetor 2016 kapitali aksionar i autorizuar ishte i përbërë nga 28,530 aksione të zakonshme (2015: 28,530 aksione të zakonshme). Aksionet e zakonshme kanë një vlerë nominale prej 394.2 Euro secili (2015: 394.2 Euro). Pronarët e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të marrin dividendë që deklarohen kohë pas kohe dhe kanë të drejtën e një vote për aksion në mbledhjet e Bankës.

Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me mjetet e mbeturat të Bankës.

Një përbledhje e strukturës së pronësisë është si vijon:

Banka për Biznes Sh.a.
Shënime për Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016
(Shumat janë në mijë Euro, përvç nëse shprehet ndryshe)

23. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT (VAZHDIM)

<i>Emri i aksionarit</i>	2016		2015	
	%	EUR ('000)	%	EUR ('000)
1 Afrim Govori	21.27	2,392	21.27	2,392
2 Rrustem Aliaj	17.27	1,942	17.27	1,942
3 BERZH	10.00	1,125	10.00	1,125
4 Shaqir Palushi	9.91	1,115	-	-
5 John Xhan Taip	-	-	9.91	1,115
6 Mejdi Rexhepi	9.35	1,052	9.35	1,052
7 Nazmi Viçë	6.89	775	6.89	775
8 Kareman Limani	4.85	545	4.85	545
9 Banka di Cividale	4.62	520	4.62	520
10 Ahmet Arifi	2.39	269	2.39	269
11 Ismet Sylejmani	1.90	214	1.90	214
12 Rasim Gashi	1.54	173	1.54	173
13 Riza Mikullovci	1.45	163	1.45	163
14 Others	1.26	141	1.26	141
15 DMTH shpk	5.35	601	5.17	581
16 Naser Aliu	0.62	70	0.62	70
17 Besnik Vrella	0.62	70	0.62	70
18 Agim Bilalli	0.62	70	0.62	70
19 Flamur Bryma	0.09	10	0.27	30
Gjithsej	100.00	11,247	100.00	11,247

Rezerva tjera

Rezerva tjera të kapitalit janë krijuar që nga 31 dhjetori 2011 si diferençë midis humbjes së akumuluar në përputhje me SNRF dhe BQK të cilat janë fshirë me anë të një reduktimi në kapitalin aksionar. Si rezultat i kësaj, këto rezerva janë të kufizuara dhe nuk mund të shpërndehen.

Rezerva për rivlerësim

Gjatë vitit 2014, Banka ka vendosur të përfshijë në kategorinë e pronës dhe pajisjeve një ndërtesë e cila ka qenë me parë pasuri e riposeduar. Ndërtesa u njoh nga Banka në prona dhe pajisje me shumën korresponduesh në rezervën e rivlerësimit në kapital.

24. ZOTIMET DHE KONTIGJENTET

Banka lëshon garacion për klientët e saj. Këto instrumente bartin një rrezik kreditimi të ngjashëm me ato te kredive të dhëna. Garacionet e lëshuara në favor të konsumatorëve janë siguruar me kolateral në para dhe kolateral jo në para (pasuri të paluajtshme dhe kolateral të luajtshëm).

Garacionet e lëshuara të klientëve	2016	2015
Të siguruara me depozita kesh	828	525
Të siguruara me kolateral (patundshmëri dhe kolateral i luajtshem)	604	1,133
Të pasiguruara	794	996
Minus: Provizonet e njohura si detyrime	(58)	(66)
Gjithsej	2,168	2,588

Zotimet përfaqesojnë balancat e patrëhequra të kredive, mbitërheqjeve dhe limitet e kredit kartelave të lëshuara të klientët.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimë për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016

*(Shumat janë në mijë Euro, përvèç nëse shprehet ndryshe)***24. ZOTIMET DHE KONTIGJENTET (VAZHDIM)****Zotimet për kredi**

	2016	2015
Kreditë e aprovuara por të padisbursuara	420	581
Limitet e pashfrytëzuara te mbitërheqjeve	4,779	3,896
Kredit kartelat e pashfrytëzuara	416	434
Gjithsej	5,615	4,911

Ligjore

Banka përfshihet ne procedura te zakonshme ligjore ne rrjedhën normale të biznesit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Mendimi i menaxhmentit është se rezultati përfundimtar i këtyre padive nuk do te ketë një efekt material në rezultatet e Bankës, përvèç provizioneve te cilat janë njojur në pasqyrën e fitimit ose humbjeve.

Zotimet e qerasë

Banka ka zotime për qera të cilat janë te detyrueshme e që përbëhen si në vijim:

	2016	2015
Jo më vonë se 1 vit	510	482
Me shume se një vit dhe jo më shumë se 5 vite	113	186
Gjithsej	623	668

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016

(*Shumat janë në mijë Euro, përvèç nëse shprehet ndryshe*)

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

(a) Hyrje dhe permblehdhje

Banka eshte e eksposuar ne rreziqet e meposhtme nga perdonimi i aktiveve financiare:

- riku i tregut ;
- riku i kreditimit ;
- riku i likuiditetit .

Ky shenim prezanton informacion per eksposimin e bankes ndaj seclit nga rreziqet e permendura me lart, objektivin e Bankes, politikat dhe procedurat per matjen dhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kapitalit te Bankes.

Korniza per menaxhimin e riskut

Bordi i drejtoreve (“Bordi”) ka perjegjesi per themelin dhe mbikeqyrjen e kuadrit per menaxhimin e riskut te Bankes. Bordi ka themeluar Keshillin e Aktiveve dhe Detyrimeve (“ALCO”), Keshillin e Krediv, Keshillin e Auditimit dhe Keshillin e Riskut, te cilet jane perjegjes per zhvillimin dhe monitorimin e politikave te Bankes mbi menaxhimin e riskut ne fushat e tyre specifike. Keshillet e bordit kane anetare ekzekutive dhe jo ekzekutive dhe raportojne rregullisht tek Bordi i Drejtoreve per aktivitetet e tyre. Politikat e Bankes per menaxhimin e riskut jane themeluar per te identifikuar dhe analizuar rreziqet me te cilat ballafaqohet Banka, per te vendlor kufizimet e duhura te riskut dhe kontrollit si dhe te monitorojne riskun dhe respektojne limitet. Politikat dhe sistemet per menaxhimin e riskut rishikohen rregullisht per te pasqyruar ndryshimet ne kushtet e tregut, produktet dhe sherbimet e ofruara.

Banka permes trajnimeve, procedurave dhe politikave per menaxhim, synon te zhvilloje nje ambient kontrollues konstruktiv, ne te cilin te gjithe punonjesit i kuptojne rolet dhe detyrimet e tyre.

Keshilli i Auditimit te Bankes eshte perjegjes per monitorimin e pajtuesherise me politikat dhe procedurat per menaxhimin e riskut te Bankes dhe per te vleresuar pershatashmerine e kornizes per menaxhimin e riskut ne raport me rreziqet me te cilat perballat Banka. Keshilli i Auditimit te Bankes ne keto funksione ndihmohet nga Departamenti per Auditimin e Brendshem. Auditimi i Brendshem kryen rishikimet e rregullta dhe ad-hoc te kontrollit dhe procedurave per menaxhim te riskut, rezultati i te cilave raportohet tek Keshilli i Auditimit.

Banka operon ne kushtet e nje krize globale financiare dhe ekonomike dinamike ne zhvillim e siper. Zgjerimi i saj mund te rezultoje ne implikime negative ne pozicionin financier te Bankes. Menaxhmenti i Bankes monitoron qdo dite pozicionin e aktiveve dhe pasiveve, te ardhurave dhe shpenzimeve si edhe te zhvillimit te tregjeve financiare nderkombetare. Bazuar ne kete, menaxhmenti analizon perfittuesherine, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe implementon masa te pershatashme ne lidhje me kredi, tregun (kryesisht normen e interesit) dhe rrezikut te likuiditetit, duke kufizuar keshtu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Ne kete menyre Banka i perqigjet sfidave te tregut duke mbajtur nje kapital te mjaftueshem dhe nje pozicion likuiditeti.

(b) Risku kreditor

Risku kreditor eshte riku i humbjeve financiare per Banken nese nje klient apo nje pale tjeter e lidhur per nje instrument finanziar deshton te permbush detyrimet kontraktuale, qe vijne nga kredite dhe paradenhet e Bankes per klientet dhe per bankat e tjera. Me qellim te raportimit te menaxhimit te riskut, Banka merr parasysh dhe konsolidon te gjitha elementet e eksposimit ndaj riskut kreditor (te tilla si risku standard i huamarresit individual, riku shteteror dhe sektorial).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënie për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016

*(Shumat janë në mijë Euro, përvëç nëse shprehet ndryshe)***25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(b) Risku kreditor (vazhdim)****Menaxhimi i riskut kreditor**

Bordi i Drejtoreve e ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e riskut kreditor te Komiteti i Riskut qe aprovon te gjitha ekspozimet kreditore për këto kategori: kredi biznesi SME dhe kredi personale PI deri ne 50 mijë Euro, te cilat duhet te aprovohen nga Departamenti i Riskut.

Ekspozimet kreditore me te mëdha se 50 mijë Euro dhe me pak se 10% e kapitalit te klasit te pare te Bankës aprovohen nga Departamenti i Riskut / Komiteti i Kredive, ndërsa ekspozimet mbi 10% te kapitalit te bankës duhet te aprovohen nga Bordi i Drejtoreve. Njësi te ndara te departamenteve te Riskut dhe Shitjes te Bankës janë përgjegjës për mbikëqyrjen e riskut te kredive bankare, duke përfshire:

- Përpilimi i politikave kreditore, mbulimi i kërkesave për peng, vlerësimin e kredive, kategorizimin dhe raportimin e riskut, procedurat administrative dhe ligjore, dhe përputhja me kërkesat rregullative dhe statutore;
- Rishikimi dhe vlerësimi i riskut kreditor. Departamenti i kredive vlerëson te gjitha ekspozimet kreditore qe tejkalojnë limitet e përcaktuara para lehtësimeve qe u zotohen klientëve;
- Kufizimi i koncentrimit të ekspozimit ndaj zonave gjeografike dhe industrisë;
- Vendoja e shkalleve te riskut kreditor te Bankës ne mënyre qe te kategorizohen ekspozimet sipas riskut te humbjes financiare dhe qe menaxhmenti te fokusohet ne risk. Sistemi për vlerësimin e riskut përdoret për përcaktimin ku mund te kërkohet provisionimi i humbjeve. Korniza aktuale për vlerësimin e riskut përbehet nga 5 shkalle te ndryshme te riskut te mospagimit dhe disponueshmerisë se pengut;
- Rishikimi i pajtueshmërisë me limitet e miratuarat te ekspozimit, duke përfshire ato për industritë, rreziqet e vendit dhe llojet e produkteve;
- Raportet e rregulla për ekspozimin e kredive, kategorizimin e riskut dhe provisionimin e humbjeve paraqiten tek Komiteti për Menaxhimin e Riskut Kreditor dhe ndërmirren veprimet e duhura korriguese;
- Njësive brenda departamentit kreditor u kërkohet te zbatojnë politika dhe procedurat kreditore dhe janë përgjegjës për kualitetin dhe performancën e portofolios se tyre si dhe për monitorimin dhe kontrollimin e te gjitha rreziqeve kreditore ne portofolion e tyre;
- Departamenti i auditimit te brendshëm kryen auditime te rregulla te departamentit kreditor.

Analiza e cilësisë kreditore

Tabela me poshtë paraqet skenarin me te keq te ekspozimit ndaj rrezikut kreditor te Bankës me 31 dhjetor 2016 dhe 2015, pa marre parasysh ndonjë kolateral te mbajtur ose siguri te bashkangjitur. Për pasuritë financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerat kontabël neto te reportuara ne pasqyrën e pozicionit financiar.

Banka per Biznes Sh.a.**Shenimet e pasqyrave financiare**

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

*(Shumat janë ne mijë EUR, perveç nese janë deklaruar ndryshe)***25. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Analiza e cilësisë kreditore (vazhdim)**

	Mjetet monetare dhe gjendja me BQK		Investimet (AFS/HTM)		Kredi dhe paradhënie klientëve		Pasuri të tjera financiare		Garacionet financiare	
	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015
Eksposimi maksimal kundrejt rishkut kreditor										
Vlera kontabël	39,939	34,159	18,267	10,372	103,149	87,025	237	291	-	-
Shuma e zotuar /garantuar	-	-	-	-	-	-	-	-	7,841	7,565
	39,939	34,159	18,267	10,372	103,149	87,025	237	291	7,841	7,565
<i>Sipas kostos se amortizuar</i>										
Pa vonesa dhe zhvlerësimë	39,939	34,159	18,267	10,372	89,017	75,035	237	291	-	-
Me vonesa por te pa zhvlerësuara	-	-	-	-	12,490	9,489	-	-	-	-
Te zhvlerësuara	-	-	-	-	6,309	6,916	-	-	-	-
	34,159	18,267	10,372		107,816	91,440	237	291	-	-
Gjithsej										
Lejimet për zhvlerësimë (individuale dhe te përgjithshme)	-	-	-	-	(4,667)	(4,415)	-	-	-	-
	39,939	34,159	18,267	10,372	103,149	87,025	237	291	-	-
Vlera neto e mbartur										
Jashtë bilancore: eksposimi maksimal	-	-	-	-	-	-	-	-	5,615	4,911
